



PROCESVERBALI

-III- Nr. i prot.

2504

Më 31.08.2018

Br. prot.

RAHOVEC - ORAHOVAC

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 26.07.2018 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

Kryesuesi – Fillimi shqyrtim më lejoni që të ju njoftoj se Kryetari dhe nënkyetari kanë një takim dhe nuk munden që të jenë prezent në fillim të mbledhjes, por besoj se më vonë do të na bashkëngjiten. Përshëndetje për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, Drejtoret e Drejtorive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,
3. Shqyrtimi i Raporti gjashtë mujor finansiar për vitin 2018,
4. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,
5. Shqyrtimi i informatës mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së,
6. Shqyrtimi i informatës rrëth dëmeve në bujqësi,
7. Shqyrtimi i informatës rrëth dëmeve në amvisëri dhe ekonomi Familjare,
8. Shqyrtimi i informatës rrëth dëmeve në infrastrukturë publike,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P - 71510057- 06249 – 0,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510056 – 02240 - 1,
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510057 – 02267 – 0,
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510068 – 01396 – 0,
13. Shqyrtimi i Kërkesës së Kryetarit të këshillit të prindërve të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi - Po ashtu desha që ti njoftoj kuvendarët se pasi të përfundoj mbledhja e kuvendit, të qëndrojnë në sallë të kuvendit që ta zgjedhin grupin jo formal të gruas, sepse vetëm Komuna jonë ka mbetur pa e formuar. E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së parë të rendit të ditës. Nëse jo atëherë e qes në aprovim Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin dhe ju jap fjalën juve kuvendarëve nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje: Ne tani jemi në fund të muajit shtatë (7) dhe mendoj se është dashur të jetë në këtë mbledhje raporti i punës së Kryetarit të Komunës për 6 mjuorin e këtij viti, desha ta di pse nuk është dhe a do të jetë në mbledhjet e radhës.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime ka të bëjë me qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulantët e Komunës së Rahovecit, kjo pyetje shkon për Drejtorin e Shëndetësisë: A është bërë DD që i bije dezinfektimi kundër insekteve, dezinfektimi kundër baktereve dhe dëratizimi kundër minjve. Sipas informatave që i kam nga inspektorati sanitari rajonal që nuk është bërë. Po ashtu desha të ndërlidhem me QMF-në në Fortesë, pyetje ime është pse kjo QMF nuk a stomatolog pasi që në të kaluarën ka pasur dhe aparatura për stomatologji ekziston në këtë QMF, po ashtu pse në këtë QMF nuk ka pastrues kur e dimë se aty shkojnë për tu kontrolluar tek mjeku diku 50 pacient në ditë.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime ka të bëjë me subvencione, kisha dashur një përgjigje sa më konkrete nga ana e juaj sa i përket subvacioneve sepse është shumë shqetësuese fakti, pos që u dëmtuan nga reshjet e mëdha që ndodhen në Komunën tonë buqit po ashtu janë duke u neglizhuar në anën tjetër, ne këtu në Kuvend ndamë po ashtu një shumë tejet simbolike ku edhe për këtë dua një përgjigje sepse ne të gjithë së bashku e miratuam atë vendim, mendoj se do të ishte edhe më e vlerësuar nga të gjithë ne po që se mësojmë se të paktën dikush përfitoj nga ky vendim. Gjithashtu dua ta di se kur do të fillojnë të marrin qytetarët tanë subvencionet në mënyrë që të mundohen të i ripërtërin dëmet që u janë shkaktuar, përndryshe nëse ato vazhdojnë që të vonohen edhe më tepër atëherë kjo është një mos përfillje nga ana e juaj sepse gjithmonë kur këta qytetar neve na duhen ne ju premtojmë ose rritje ose dhënie me kohë të subvacioneve. Përpos të tjera kam edhe një kërkësë të cilën e them me plotë konsideratë, tani jemi në kohën kur ka filluar vera dhe frekuentimi dhe rritja e veturave në lokalitetin tonë ka filluar, e kam fjalën për ardhjen e njerëzve tanë nga diaspora. I nderuar Kryetar nëse ekziston mundësia që ju së bashku me institucionet përkatëse shtetërore të gjeni zgjedhjen e duhur se si të parandalohen incidentet dhe më të papriturat, prandaj ju lusë që të vendosni ndonjë shenjë sinjalizuese për parandalimin e shpejtësisë në hyrje të fshatit Ratkoc, përkatësisht tek shtëpitë e familjes Morina.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj sa i përket fushës së arsimit, të nderuar në Komunën tonë funksionojnë 28 shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme, në shumë shkolla ekziston rrjeti i vjetër elektrik i cili është rrezik potencial për sigurinë e nxënësve. Kurse sa i përket kushteve të mësimit për nxënës të Komunës sonë, vetëm në 14 shkolla ekzistojnë kabinete mësimore, prandaj pyetja ime është : Kur do të filloj plani për pajisje me këto kabinete në atë shkolla ku mungojnë kabinetet.

Dervish Cadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar nëse ne e marrim një turistë dhe ja mbyllim shtë dhe e lëmë në mes të qytetit të Rahovecit, pastaj ja hapim shtë ai do të befasohet me pamjen e parqeve dhe rrëth rrotullimeve në Rahovec krashtsim me fushën në Rahovec që është një bukur natyrore të cilën qytetarët e Rahovecit e kanë kultivuar edhe më shumë, ka njerëz që ndalen dhe bëjnë foto me ato pamje kaq të bukura të vreshtave dhe fushave në përgjithësi. Por nëse i shohim rrëth rrotullimet dhe parqet e qytetit të Rahovecit që kompetent për mirëmbajtjen e tyre është Komuna, do të shihni se ato janë për tu vajtuar. Pastaj varrezat dhe përmendoret e dëshmorëve janë jo të mirëmbajtura

dhe është shumë keq nëse vije dikush dhe e sheh në atë gjendje përmendoren e një dëshmori është për të ardhur keq. Pastaj në rrëth rrëtullime është ritë bari dhe janë aty disa pisha me ngjyrë kafe që askund tjetër nuk kam parë vetëm në këto rrëth rrëtullime. Prandaj të nderuar është në duart e juaja që këto që i përmenda të rregullohen sepse ju jeni kompetent për këtë punë.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një kërkësë specifike pasi jemi edhe afër pragut të fillimit zë vitit shkollor 2018/2019, duke e ditur se gjendja e shkollës filllore “Liria” në Fortesë është në një gjendje të mjerueshme dhe sa herë që ka vërvshime ajo shkollë përfshihet, pastaj ka mykë dhe shumë erëra të tjera. Pjetja ime shkon për Drejtorin e DKA-së, pasi nuk ka të mundësi që për këtë vit të filloj ndërtimi i kësaj shkolle kishte me qenë mirë që së paku para fillimit të vitit shkollorë në këtë shkollë të intervenohet, të lyhet që sadopak ai mykë të hiqet që nxënësit mos të ja fillojnë mësimit në ato hapësira që është e pamundur të zhvillohet procesi mësimor në suaza të normales.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, rruga Fortesë – Celinë është kërkësë e qytetarëve që të lirohet pak komunikacioni sepse në atë rrugë ka shumë policë të shtrirë që janë vendosur nga qytetarët pa kurrfarë standardi. Kërkesa e qytetarëve është që të vendosen policë të shtrirë nga Komuna në ato vende ku është e nevojshme dhe me standarde.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kolegja e përmendi dhe e mbështes propozimin e saj, më duke se është nënshkruar kontrata për sinjalizim horizontal dhe vertikal, por nuk e kam parë një plan se çka do të punohet në këtë mandat 2 vjeçar, e them këtë sepse sa e di kontrata është dy vjeçare. Pjetja ime është a ka ndonjë plan se ku dhe çka do të punohet, p.sh rruga Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel që lidhet me Çifllak është pa sinjalizim horizontal, kjo rruga ka nevojë për sinjalizim, po ashtu ka nevojë edhe për disa sinjalizime të veçanta.

Trajko Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, rruga “Bekim Isma” në lagjen e epërmë që fillon nga ambulanta e deri tek fabrika e plastikës, anësh kësaj rruge janë rritur disa drunjëtë ku pengojnë qarkullimin e lirë të makinave, po ashtu prezanton një rrezik edhe për këmbësorët të cilët ecin.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ngris në çështje sa i përket shëndetësisë që ka të bëjë me objektin e ri të qendrës për mjekësi familjare që është duke u ndërtuar, ajo që na ka ra në sy mua dhe mjekëve tjerë që jemi duke punuar në QKMF në Rahovec është se ky objekt për brenda nuk ka dritë të mjaftueshme, është objekt i madhe dhe i bukur por është i errët dhe ne në të ardhmen kur të dalim në atë objekt në shumicën e kohës do të jemi të detyruar që të punojmë me dritën e korrentit dhe kjo nuk është në rregull sepse puna në shëndetësi duhet që të bëhet përmes dritës së diellit. Prandaj propozoj që të formohet një grupe ose komision nga Komuna me profesionistë si inxhinier dhe mjekë me përvojë dhe të shikohet gjendja reale se si është dhe të shikohet se a ka mundësi të korrigohet tanë në këtë fazë diçka sepse më vonë besoj se do të jetë shumë më vështirë.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për drejtorin e DKA-së rrëth shkollës “12 Maji” Ratkoc, i nderuar kjo shkollë është në një gjendje shumë të mjerueshme dhe ata nxënës aq të mrekullueshëm nuk e meritojnë të vijojnë mesmin në atë shkollë, pyetje ime është: A pritet që të ndermirët diçka gjatë pushimit verorë në atë shkollë, a keni në planë që të bëni një renovim të atij objekti.

Kryesuesi – Ju faleminderit për pyetjet e parashtuara, nëse ka përgjigje tanë ndonjëri nga drejtorët mundet të ju përgjigjet kuvendarëve, nëse jo mundet edhe në mbledhjen e radhës.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po i përgjigj z. Dervish Çadrakut, i nderuar është e vërtet ajo që e thatë, ne këtë vite e kemi trashëguar një kontratë ku hapësirat publike janë mirëmbajtur dy herë në vite, por ne në qytetin e Rahovcit sa për informatë 4 herë kemi ndërhyrë. Po ashtu sot po ju informoj se 30 punëtorë sezonal kanë filluar punën në Komunën e Rahovcit, në Rahovec po punojnë 8 për momentin punëtor të cilët janë duke pastruar rrëth rrëtullimet dhe hapësirat ku janë drunjëtë dekorative. Po ashtu ju informoj se 7 punëtorë kanë refuzuar kontratat për punësim sezonal arsyesa është se kanë menduar që nuk duhet të punojnë por vetëm të marrin para nga ministria, pra nga 30

sa kanë qenë në fillim tani janë të angazhuar 22 punëtorë sezonal të cilët pastrojnë ambientin. E nderuara znj. Florije Boshnjaku mendoj se tek hyrja në Fortesë ka shumë pengesa dhe duhet të hiqen të gjitha, po ashtu ajo rrugë është e demoluar dhe së pari kishte me qenë mirë që ajo rrugë të shtrohet e re dhe pastaj të vendosen pengesat me standarde nga Komuna edhe pse ndoshta nuk është dashur fare të vendosen në vendbanime sepse në vendbanime duhet që të vozitet me një kujdes shumë të madh, por ja që tek ne vozitet shpejtë prandaj jemi të detyruar që të vendosim pengesa. Por sidoqoftë ne kontratën e kemi lidhur dhe që nga java e ardhshme do të fillojmë me sinjalizimin horizontal në qytet, pastaj prioritet është rruga Drenoc – Sarosh sepse kjo rrugë asnjëherë nuk ka pasur sinjalizim horizontal, pastaj sipas kërkesave të banorëve do të vendosen pasqyrat edhe pse kemi shumë kërkesa por për atë do të vendos një komision i përbashkët nga policia dhe drejtortë përkatëse të Komunës. Z. Trajko Shariq e pati një pyetje për rrugën “Bekim Isma”, i nderuar javën e ardhshme pritet të lidhet kontrata për meremetim të rrugëve dhe në kuadër të kësaj është e paraparë që të bëhet edhe zgjerimi i kësaj rruge, po ashtu nëse ekziston mundësia do e zgjerojmë edhe me asfalt sepse kjo rrugë është shumë e ngushtë dhe me këtë do të krijohen kushte më të mira të lëvizjes në këtë segment rrugor.

Avni Morina – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, po filloj që të përgjigjem pyetjeve nga znj. Shqipe Kryeziu, e nderuar e di shumë më mirë se ju se në çfarë gjendje është kjo shkollë sepse kamë punuar 20 vite në këtë shkollë, por e nderuar fillimisht gjatë verës në atë shkollë do të nderohen 7 dyer të klasave, po ashtu kemi ardhur në përfundim se në atë shkollë nuk mundet që të investohet asgjë deri sa të hiqet uji nga podrumi. Në projekt buxhet për këtë vit nuk është paraparë asgjë, por së pari do të bëjmë drenazhimin e objektit, pastaj do të ndërmerrin masat për eficiencë të energjisë për këtë shkollë, dy projekte për këto dy intervenime për këtë shkollë do i bëjmë këtë vit në projekt buxhet. Pyetje tjetër ishte nga znj. Hanalora Hoti, e nderuar ne do të kujdesemi që shkollat të cilat nuk kanë kabinete të shkencave të natyrës brenda kornizave buxhetore të i fusim në projekt buxhet sepse për tani nuk ka të planifikuar asgjë për këtë vit. Gjithashtu në bashkëpunim me KEDS-in do të shohim gjendjen e rrjetit elektrik edhe në hapësirën e oborreve të shkollave,, por edhe në kuadër të masave të eficencës të energjisë do të shohim edhe rrjetin elektrik që është brenda shkollave. I nderuar z. Ali Zhuniqi sa i përket shkollës në Fortesë ju e dini edhe në informatën që e kam dhënë më herët e kam cekë se kjo shkollë ka qenë në projekt të eficencës së energjisë, por pasi kemi marrë kërkesë që të ndërtohet një shkollë e re, ne në projekt buxhetin e vitit të ardhshëm do ta vendosim si prioritet për të ndërtuar një shkollë të re në Fortesë, në këtë shkollë nuk ja vlen të investohet sepse është shkollë e cila përmbytet çdo herë sa herë që bie shi. Ndërsa sa i përket atyre lyerjeve dhe intervenimeve të vogla brenda klasave ato janë të zakonshme ehe bëhen çdo vit besoj se do të bëhen edhe këtë vit, por e keqja është se ajo shkollë prapë do të vije në këtë gjendje. Po ashtu gjatë kësaj periudhe kam pranuar edhe pyetje të tjerë me email në lidhje me konkursin që është shpallur nga DKA-ja, pyetje më ka parashtruar znj. Vjosa Isma, përgjigjen e ka mare po ashtu me email dhe nëse ka ndonjë pyetje shtesë e nderuara mundem të i përgjigjem edhe tani.

Berat Duraku – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, e nderuara znj. Fahrije Lushi e parashtrove një pyetje sa i përket pagesës së subvencioneve. E nderuar ne si Komunë vetëm e kryejmë procesin e aplikimit dhe pastaj dokumentacioni bartet në ministri dhe pastaj ata janë ata që vazhdojnë me procedurat e tjera dhe me pagesa. Po ju njoftoj se pagesa për subvencione nga ana e qeverisë vetëm sa ka filluar dhe pagesa kryhet me fazë varësish se si janë dokumentacionet atje në ministri. Sa i përket vendimit që e kemi ndarë ne si Kuvend në shumën prej 7,000.00 €, po të njoftoj se ato mjete kanë qenë vetëm për pagesën e intervenimeve që janë bërë ato ditë, ne kemi pasur disa intervenime me operatorë si në Krushë të Madhe, Celinë, Zoqishtë, Brestoc dhe në disa rrugë në qytetin e Rahovecit. Po ashtu dua të ndaj një lajmë të mirë me ju sa i përket kompensimit të dëmeve, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim që ti kompensoj të gjitha dëmet në bujqësi, është ndarë një fond prej 6.7 milion € dhe ajo që është më e rëndësishme është se ky fond do të jetë edhe për vitet në vazhdim.

Nënkyetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të i përgjigj atyre pyetjeve që kanë mbetur, po ja filloj me z. Rasim Fazliu, i nderuar eshtë e vërtet se eshtë një praktik sa i përket raportit 6 mujor të Kryetarit të jetë në Kuvend, kjo për ne nuk ka kurrfarë pengese dhe ne e kemi përfunduar atë rapport ku janë të prezantuara aktivitetet dhe punët e kryetarit për këto 6 muajt e parë të vitit 2018, por ligjërisht eshtë që të prezantohet raporti vjetor i Kryetarit të Komunës. Sa i përket pyetjes së z. Masar Popaj, i nderuar projekti eshtë dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi, eshtë përfunduar faza e parë e këtij projekti, janë mjetet të paraparë me buxhet diku rrëth 40,000.00 €, ku pastaj do të vazhdohet me fazën tjetër, projekti ka përfunduar diku në fund të muajit qershor. Po ashtu dua ta plotësoj drejtorin z. Duraku sa i përket pyetjes së znjë Fahrije Lushi, e nderuar në bazë të takimit që kemi pasur ne ministrin e bujqësisë z. Rikallo, ku kemi kërkuar që pagesa e subvencioneve të filloj menjëherë dhe në bazë të premtimit të tije subvencionet do të fillojnë të paguhen nga data 15 gushtë, ne të gjithë e dimë se këto subvencione janë në kompetencë të kësaj ministrie, po ajo që mundet me bo Komuna në këtë rast eshtë ajo që ne e kemi bërë presion. Po ashtu kemi marrë premtim se askush nuk do të lirohet nga këto subvencione për arsyet e shumë dëmeve që kemi pësuar si nga shiu, vërvshimet dhe nga breshëri. Sa i takon fluksit të mërgimtarëve ne kemi pasur një takim me policin e Kosovës dhe ndërmarrjen Ambienti kemi biseduar sa i takon planit të policisë rrëth fluksit të mërgimtarëve, pastaj rrëth zgogëlimit të aksidenteve në komunikacion por gjithashtu edhe për pastrimin e ambientit e cila lidhet po ashtu me pyetjen e z. Dervish Çadraku. Pra ne kemi bërë një plan dhe strategji së bashku me policinë dhe Komuna sa mundet do të bëjë në këtë drejtim, do të ndërmarrim ato hapa të cilat duhet për të i pritur bashkatdhatarët tanë, po ashtu e kemi zgjatur edhe orarin e punës, pastaj punohet edhe të shtunave, për respekt ndaj tyre e kemi ndarë po ashtu edhe një parking pa pagesë për bashkatdhatar. Sa i përket pyetjes së z. Fehmi Cena, i nderuari doktor ju e dini se ky projekt eshtë bërë më herë, e kemi këtu ish drejtorin e shëndetësisë tanë kuvendar z. Munib Durguti, besoj se atëherë eshtë paraparë se çka duhet dhe çka nuk duhet, nëse eshtë ashtu siç e thua ti asgjë të keqë nuk ka nëse shkohet për tu evidentuar se a qëndron kjo që e thua ti se ka objekt ka mungesë dritash, nëse eshtë ashtu siç e thua të atëherë duhet të shikohet se çka mundet të bëhet. Siç e dini ky eshtë një objekt i madh dhe aty edhe drita e diellit eshtë shumë vështirë që të depertoj. Ne do të kontaktojmë edhe me Drejtorin e shëndetësisë po ashtu edhe me organin mbikëqyrës dhe të shohim se çka mundet të bëhet që të ketë sa ma shumë dritë artificiale në këtë objekt.

Munib Durguti - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, meqenëse u ngritë çështja e QKMF-së dhe ndërtimit të objektit të emergjencës , ky projekt eshtë hartuar në vitin e kaluar, po ashtu desha që të ju njoftoj se ne nuk kemi ndonjë udhëzim administrativ për ndërtimin e qendrave kryesore të mjekësisë familjare, por vetëm ka qenë një udhëzim administrativ për ndërtimin e qendrave. Kompania projektuese në atë kohë e ka shqyrtuar mirë këtë udhëzim dhe ka bërë një bashkë dyzim mes standardeve spitalore dhe qendrave të mjekësisë familjare, as unë nuk mundem që të jem i kënaqur me ndriçimin natyrorë që e ka ky objekt, por nuk eshtë e ndaluar që të bëhet ndërhyrje në projekt. Në disa raste këtë ndryshim mundet që të inicioj edhe këshilli drejtues i QKMF-së duke u bazuar në disa standarde të OBZH-së, ku sipas tyre objektet shëndetësore duhet që të kenë ndriçim natyrorë mbi 30%. Ka fundi i mandatit e kam dhënë një propozim: Në hyrje të QKMF-së ka paralelja e rrugës kryesore, mbi këtë hyrje të mos vendosen fare zyre, ajo pjesë të jetë vetëm për ndriçim ku munden të vendosen vazo me lule dhe me këtë mendoj se do të arrihet ky standard i kërkuar, por siç e di tani aty janë vendosur zyre. Prandaj mendoj se tani eshtë koha që të iniciohet një kërkësë e arsyeshme tek organi mbikëqyrës dhe pastaj organi mbikëqyrës të kërkoj nga hartuesi i projektit që të bëhen ndryshimet e nevojshme dhe besoj se kjo nuk do të ketë kosto dhe komplikime në projekt.

Dervish Çadraku – Kur diskutova më parë për parqet, nuk e pata fjalën për luftën me natyrën p.sh kur bari bien ne me të shkojmë me kosit, por unë e pata fjalën tek natyra jonë e njerëzve qytetar që tregon edukatë dhe kulturë në mbledhjen luleve të ndryshme dhe bimëve dekorative. Pra udhëheqja e Komunës

nuk ka bërë në këtë drejtim asgjë , prandaj nëse dëshirojmë që të tregojmë një edukatë dhe kulturë duhet që këto parqe dhe rreth rrrotullime të i mbushim me lule që ne i kultivojmë, pra nga dora e njeriut.

Nënkyryetari – Sa i takon kësaj i nderuari z. Dervish Çadraku në buxhet nuk ka pasur të paraparë në buxhet asgjë, ju e dini se të gjitha punët kryhen nëse janë të paraparë në buxhet mjetet, por ajo që intervenohet sot në këto parqe dhe rreth rrrotullime është prerja, kositja e atij bari, duke mos harruar që edhe qytetarët duhet që të janë pak më të vetëdijshëm që së paku barin para shtëpisë së vetë ta pastrojnë siç ka qen praktik më herët, e jo që të presin që edhe para dyerive të tyre të vije Komuna me ja kositë barin. Pajtohem m me ju që të parashihen mjetet për vitin e ardhshëm për këtë punë dhe besoj se do të rregullohet kjo. Sa in përket diskutimit që e tha kuvendari z. Munib Durguti, i nderuar për këtë projekt mundën të jepen ide dhe aty ku është keq Komuna e ka për obligim që të intervenoj dhe besoj se do të intervenojmë në ato pjesë ku e potencoi doktori në mënyrë që të bëhet më e mira e mundshme sepse është një objekt që ka me i shërbye të gjithë qytetarëve të Komunës sonë.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raporti gjashtë mujor financier për vitin 2018.

Afrim Limani – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, drejtori Limani prezantoi para anëtarave të Kuvendit Raportin 6 mujor financier të qeverisë Komunale për vitin 2018, ku në veçanti i njoftoi anëtarët e Kuvendit Komunal se në këtë raporte janë të përfshirë të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me çështje financiare brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018. Drejtori Limani potencoi se ky raport përbëhet nga dy pjesë, të hyrave e cila për periudhën 6 mujore të vitit 2018 ka arritur vlerën prej 456,125.019 €, dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi pasur një ndryshim pozitiv. Ndërsa pjesa e shpenzimeve të buxhetit për periudhën e parë 6 mujore të vitit 2018 ka qenë i shpenzuar në masën prej 54.28%. që konsiderohet si pozitive.

Mirjeta Krasniqi – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket rapportit financier të 6 mujorit të parë të vitit 2018 dhe krahasimi me vitin paraprak, desha të ndërlidhem tek disa çështje. Në faqe nr.12 tek shërbimet, totali i shpenzimeve të asamblesë komunale kemi një shifër diferencë me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë rreth 7,000.00 €, dua ta di se ku janë bërë këto shpenzime. Pastaj në kodin 13440 është një shërbim që nuk e kuptoj ku janë bërë shpenzime rreth 1.300.00 €, pastaj kodi i shërbimeve shtyp. jo. mark. shpenzime rreth 3,937.00 €, dreka zyrtare rreh 872.00 €, për vete nuk e di që kam hëngër ndonjë drekë, por ndoshta kolegët e tjerë kanë hëngër. Po ashtu edhe tek zyra e Kryetarit kemi një rritje të vlerave në disa kode ku totali i vlerës është shumë i madh, nga 9,474.00 € që ka qenë në vitin e kaluar, tanë është vlera është mbi 28,000.00 €, lusë drejtorin të na sqaroj se çka janë këto ndryshime të shifrave.

Shqipe Kryeziu – Po ashtu edhe unë desha të ndërlidhem sa i përket shpenzimeve tek zyre e Kryetarit, ishte me qenë mirë të na tregoni se cilat janë ato shërbime të kontraktuara të tjera, në zyrën e Kryetarit vitin e kaluar kanë qenë shpenzime 1,428.00 €, ndërsa këtë vit shpenzime janë 7,184.00 €. Pastaj sa i përket asamblesë, nuk e di që ka veturë të veten asambleja, vitin e kaluar për veturën e asamblesë janë bërë shpenzime 143.00 €, kurse këtë vit shpenzime janë bërë 220.000 €. Ndërsa sa i përket mirëmbajtjes së veturës së asamblesë janë bërë shpenzime diku 829.000 €. Shpenzime në blerje të mobileve kemi po ashtu mjaftë, vitin e kaluar ka qenë 2,864.00 €, ndërsa në këtë vit kemi shpenzime për blerje të mobileve 15,323.00 €, a duhet çdo drejtori të blejë mobile, ku pe ceki Drejtorin e Kulturës e cila i ka bërë disa shpenzime për blerje të mobileve me vlerë prej 7,733.00 €, kjo është një shumë e madhe.

Florije Boshnjaku – Falënderoj Drejtorin e Financave që na ka sjellë këtë raport me këto të dhëna, ku na ka pajisur mjaft me informata sa i përket buxhetit të Komunës. Por kam disa sugjerime për të ardhmen që në faqe nr.6 ku ceket krahasimi i të hyrave të realizuara për periudhën janar – qershori sipas kodeve ekonomike. Ajo që më intereson mua është kodi 50015 taks për certifikatat e vdekjes, për vitin 2018 kanë qenë të paraparë 5,000.00 €, ndërsa në vitin 2017 vetëm 519.00 € ka pasur të hyra, kurse në vitin 2018 kanë qenë të hyra 842.00 €, propozoj që për vitin 2019 të mos parashihet kjo shumë sepse është

parealizueshme. Pastaj kodi 50016 taksat dhe certifikatat e tjera të ofiqaris, për vitin 2018 janë të paraparë 20,000.00 €, në vitin 2017 kemi pasur të hyra në këtë taks 692.00 €, kurse në vitin 2018 kemi pasur 477.00 €, edhe për këtë taks propozoj që mos të parashihet kjo shumë e madhe sepse siç e thash nuk munden të sigurohen këto të hyra. Kodi 50026 taks për legalizim të objekteve kanë qenë të paraparë 45,000.00 €, në vitin 2017 të hyrat kanë qenë zero, ndërsa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 po ashtu zero, kishte me qenë mirë edhe nëse e parashihni këtë kod të jetë një shumë më e vogël sepse me këto parashikime jemi duke dalë joserioz për mbledhjen e këtyre të hyrave. Kodi 50201 licencat aktive individuale të lira, kanë qenë të paraparë 400,000.00 € apo 400.00 €, këtë nuk e kam të qartë kishte me qenë mirë të më shpjegoni drejtor se cila është e saktë.

Vahid Krasniqi – Desha të diskutoj sa i përket këtij reporti janar – qershor edhe pse diçka që më shqetësoj mua i ceku edhe kolegia znj. Mirjeta Krasniqi. Kur në është prezantuar rapporti 3 mujor financiar kam kërkuar nga drejtori i financave një sqarim sa i përket kodit të mirëmbajtjes së automjeteve, ku më është premtuar se në raportin 6 mujor do të cekë tek shpenzimet e bartura, i pashë shpenzimet e bartura së mënyrë formale, por përpos këtyre shpenzimeve janë të cekura edhe shpenzimet e avokaturës, shërbimet dhe kontratat e tjera, shërbimet për anëtarësim, për karburante të veturës e arsyetoj Kryetarin, pastaj dreka zyrtare dhe e fundit mirëmbajtja e automjeteve. Për këtë e kam kërkuar një raport të detajuar për arsy që ta di se sa vutura janë mirëmbajtur, pastaj kush i mirëmban ato, pastaj për secilën vuturë që mirëbahet është dikush që e lëshon një faturë, pastaj çfarë vture ka qenë dhe sa vutura kanë qenë, këtë e kam kërkuar unë në raportin 3 mujor por më është premtuar se në raportin 6 mujor do i kem këto informata.

Ali Morina – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, parafolësit pothuajse i cakën të gjitha vërejtjet shumica nga ato ishin edhe ato që më shqetësonin edhe mua, ajo që është pozitive për këtë raporte është rritja e të hyrave edhe pse nuk është ndonjë shumë e konsiderueshme, por kjo tregon një sinjal pozitiv për të hyrat e Komunës së Rahovecit, ku shpresojmë se këto të hyra të vazhdojnë të ritën edhe në 6 mujorin e dytë të vitit 2018, ku me rritjen të këtyre të hyrave do të ndikojë pozitivisht zhvillimi i qeverisjes komunale si dhe do të bëhet realizimi i projekteve të planikuara. Ajo që më la përshtypje është po ashtu edhe verifikimi i objekteve tek tatimi në pronë ku kemi një rritje pothuajse 100%, pastaj paraqitja e nënshkrimit të kontratave publike më ka lënë po ashtu përshtypje. Kjo tabelë që na është ofruar neve paraqet një transparencë më të mirë qoftë për ne si kuvendarë po ashtu edhe për gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, me anë të këtij rapporti do të mundemi me e përcjellë të gjithë aktivitetin që e ka pasur Komuna e Rahovecit po ashtu do të ritet transparenca nga ana e ekzekutivit të Komunës.

Florida Bajraktari - Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, në faqe nr.12 ceket furnizimi i zyrës për secilën kategori, dua ta di se me çka janë furnizuar këto zyre sepse e kemi të pa qartë.

Masar Popaj – Tek krahasimi i të hyrave tek kodi 50407 qiraja e vendosjes së objekteve tregtare, në vitin 2017 kemi pasur 74,714.10 € kurse në vitin 2018 kemi 30,305.52 €, që i bie në vitin 2018 kemi më pak të hyra me vlerë prej 44,408.58 € që në përqindje i bie minus 59.44%, është një diferencë e madhe nëse e krahasojmë me vitin 2017.

Ali Zhuniqi – Po ashtu dhe unë desha të ndërlidhe sa i përket zyrës së Kryetarit, e ceken edhe kolegët më herët disa shqetësime, por unë desha ta di se çka ka dallim Kryetari i kaluar nga ky i tanishëm ku në raport me totalin na paraqitet një diferencë prej 18,526.00 € përafërsisht, kërkoi nga drejtori që të na jepe një sqarim rrëth kësaj. Po ashtu edhe tek mirëmbajtja e automjeteve ka një diferencë goxha të madhe në vitin 2017 ka qenë afér 980.00 €, ndërsa tanë përfshihet një shumë prej 4,475.00 €. Pastaj rapporti i mallrave dhe shërbimeve kodi 13620 furnizimi me ushqim dhe pijë, krahasuar me vitin e kaluar kemi një diferencë prej 3,925.00 €, kjo tregon se janë ngritur jashtëzakonisht shumë shpenzimet dhe për mendimin time kjo nuk paraqet një pasqyrë reale. Prapë tek rapporti 3.4 kodi si shpenzimeve në veshmbathje, vitin e kaluar ky kod është zero, ndërsa këtë vit kemi për shpenzime të veshmbathje diku 4,483.00 €. Nëse kishte me pas mundësi drejtori të na i sqaroj këto shqetësime që i ceka.

Fehmi Cena – E kam lexuar me shumë kujdes këtë raport finansiar, ku e konsideroj se është një raport gjithëpërshirës dhe për nga forma e dizajnit është punuar shumë mirë ku na jepe të dhënët e qarta sa i përket pasqyrave buxhetore për periudhën 6 mujore të vitit 2018, janë të cekura shumë qartë si të hyrat ashtu edhe shpenzimet, po ashtu edhe krahasimi me vitin e kaluar. Sa i përket planifikimit të të hyrave ne e dimë se ka qenë 1,650,000.00 €, kurse për këtë periudhë kohore janë të hyra diku 456,000.00 € ku në përqindje i bie më shumë se 27%, pastaj kur i shtohen kësaj gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatave do na del se të hyrat janë gjithsej 518,000.00 €, ku në përqindje i bie rreth 31% dhe sado që duket që ka një rritje në krahasim me vitin 2017, ky gjashtë mujor i parë nuk është inkurajues sepse kemi të bëjmë vetëm me 31% të hyra nga ajo që është planifikuar. Pastaj në faqe nr.6 i kemi të paraqitur sipas kodeve ekonomike, kodi 526 taksa për legalizimin e objekteve të paraparë janë 45,000.00 € ndërsa të hyrat janë zero, nuk e di pse është kështu a është bërë ndonjë lëshim apo si qëndron puna, apo nuk ka pasur fare objekte që janë legalizuari në këtë periudhë. Kodi 50407 qiraja nga vendosja e objekteve tregtare, gjithashtu edhe këtu të hyrat e paraparë nga kjo qira janë 82,000.00 €, ndërsa të realizuara janë afér 30,000.00 €, nuk është ndonjë dallim i madh për këtë periudhë kohore por këto janë fiksë sepse Komuna i dinë se sa lokale i ka me qira dhe vlerësimi është fiks, prandaj edhe të hyrat duhet që të janë më fiks. Pastaj nga çerdhja e fëmijëve planifikimi është 13,000.00 €, kurse të realizuar janë më pak se 5,000.00 € për këtë 6 mujor, të hyrat në çerdhe janë nga numri i fëmijëve që janë të regjistruar aty, këto janë tregues dhe nëse të hyrat janë në një diferencë kaq të madhe nga planifikimi atëherë duhet të shikohet se diçka nuk është në rregull, ndoshta nuk a fëmijë të mjaftueshëm dhe nëse kjo qëndron kështu atëherë çka është duke ndodhur me stafin i cili punon në këtë çerdhe, ndoshta dikush rinë dhe merre rrrogë nga buxheti i Komunës. Ne jemi duke kërkuar po ashtu hapje të çerdheve të reja, por nëse kjo ekzistuesja nuk ka mjaftë fëmijë atëherë ne duhet që të mendojmë në të ardhmen kur kërkojmë ndërtimin e çerdheve se a ka indikacion për atë, kjo është vetëm një shembull. Kodi 50409 tek shëndetësia, planifikimi tek participimi ka qenë 48,000.00 € kurse ty hyrat janë realizuar vetëm 16,000.00 €, në përqindje i bie 33.5 %, edhe më parë i kam cekur dy gjëra për shëndetësinë: E para rregullimi i sistemit shëndetësor dhe komisioni shëndetësor për dhënien e certifikatave shëndetësore për patentë shofer, këto janë dy shërbime të cilat krijojnë të hyra në shëndetësi, nuk e di pse sistemi i informimit shëndetësor nuk punon, mendoj se duhet që të punohet në këtë drejtim që ky sistem të rregullohet sa më parë sepse ky sistem krijon të hyrat, po ashtu përpos që e rregullon punën shëndetësore në QKMF, pra ka një farë rregull, po ashtu banka botërore e ka një fond që e ndanë për Komuna, ku për secilin pacientë ndanë mjete prej 2.40 €, pra Komuna jonë është në humbje edhe si Komunë por edhe si shëndetësi, drejtoria duhet që të punoj më tepër në këtë drejtë. SISH-i në shumicën e Komunave të republikës së Kosovës është duke punuar dhe pse mos të funksionoj në Rahovec. Edhe komisioni për dhënie të certifikatave për patentë shofer përpos që ofron shërbime qytetarëve tanë krijon edhe të hyra, vinë pacientë dhe ne duhet që ti orientojmë nëpër Komunat e tjera edhe kjo mundet të bëhet me një angazhim pak më të madh të drejtorisë për shëndetësi. Në faqe nr.10 tek pozicioni i donacioneve nuk është cekur asnjë shënim dhe sipas këtij rapporti për periudhën 6 mujore Komuna nuk ka mare asnjë donacion, por mendoj se kur jemi tek donacionet ehe ato që janë më të vogla duhet që të registrohen sepse e di që në shëndetësi ka pasur disa donacione të vogla nga vendorët dhe ndërkombëtarët por nuk po i shoh të cekura në këtë raport. Tek prezantimi i mallrave dhe shërbimeve më ka rënë në sy edhe mua mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve që është një dallim goxha i madh nëse e krahasojmë me 6 mujorin e vitit paraprak, përfundimisht nëse i shikojmë shpenzimet në secilin tabelar shpenzimet përmallra dhe shërbime së paku 100% është më i madh në krahasim me 6 mujorin e vitit 2017, mendoj se për këtë duhet të ketë shpjegim drejtori sepse kjo është pjesa ku Komuna duhet që të ketë më shumë kujdes dhe sa më shumë të kursej dhe nëse bëhet kjo Komuna mundet të realizojë ndonjërin nga projektet kapitale. Edhe në shëndetësi për këtë periudhë kohore i kemi diku rrëth 20,000.00 € shpenzime mallra dhe shërbime, nuk e di ku janë bërë këto shpenzime, është këtu një kod për mirëmbajtje të objekteve shëndetësore, kisha dashur nga drejtori të na tregoj se kjo shumë për cilën

mirëmbajtje janë shpenzuar, përndryshe në objektin e QMF-së ku unë punoj nuk është investuar asgjë rreth mirëmbajtjes edhe pse ka pasur nevojë për investime, në këtë objekt në zyrat e mjekëve janë edhe gropat e hapura, është e pa mundur të mbahet pastërtia, po ashtu kjo na pengon edhe në punën normale. Ka dy vite që kemi bërë kërkesën që të bëhen riparime por deri më tani asgjë nuk është bërë. Në faqe nr.24 janë të cekura shtigjet e ecjes në Rahovec ku janë të paraparë mbi 218,000.00 €, këtë investim e përkrahi sepse Rahovecit i nevojiten shtigjet e ecjes, por kisha dashur që të na informoj dikush pak më shumë rreth planit të këtyre shtigjeve se ku janë të paraparë këto shtigje të ndërtohen.

Dervish Çadraku – Do i shprehi ato rezervat e mijë mbi objektivat e stafit komunal i cili do arrihet për këtë vit, është planifikuar diku rreth 1,650,027.00 €, por në fakte edhe këtë vite sikurse edhe vitet e kaluar është shumë problem që ky planifikim të realizohet, edhe këtë vite siç jemi duke parë që në 6 mujorin e parë të viti është realizuar vetëm 1/5 të hyrave, pra është një s'përputhje e objektivave me gjendjen faktike të kësaj situatë. Në faqe nr.6 kodi 5009 taksë komunale për leje ndërtimi, për këtë vite janë planifikuar 34,000.00 €, kurse janë realizuar vetëm 33.00 €, ndërsa në vitin 2017 janë realizuar vetëm 5,700.00 €, ndërsa tani në vitin. Pastaj taksa e ndërrimit të distanconit të tokës nuk është e paraparë fare në këtë vite, mua ajo që më intereson është a nuk do të ketë fare apo si qëndron puna. Kodi 50014 taksë mbi certifikatat e kurorëzimit, janë paraparë diku rreth 15,000.00 €, kurse janë realizuar vetëm 2,735.00 € në këtë 6 mujor, edhe për këtë dyshoj se do të arrihet ky objektiv prej 15,000.00 €. Kodi 50015 taksat e certifikatave të vdekjes janë planifikuar 5,842.00 €, pastaj gjobat nga inspektorati, si duket për këtë 6 mujor inspektorati nuk ka bërë asgjë vetëm ka fjetur sepse nuk kemi kurrfarë të hyra nga ta. Licencat e pranimit teknik të lokaleve edhe për këtë nuk është paraparë, pyetje ime është a nuk do të ketë lokale të reja apo si qëndron puna. Participim në shëndetësi janë paraparë 84,000.00 €, kurse janë realizuar vetëm 16,098.00 €, nuk e di se si do të arrihet ky planifikim. Nga kureshtja më intereson të di sa i përket ankesave, çfarë natyre kanë qenë, pastaj tek zyre e Kryetarit e kemi shpenzime 28,062.00 €, nuk e di se çka ka mundur të i shpenzoj Kryetari të gjitha këto mjete. Pastaj në faqe nr.11 e kemi raporti i shpenzimeve sipas kategorive, këtu me del se është minus 3,617,000.00 €, kurse buxheti i shpenzuar është 3,603,000.00 €, pse është më pak. Kemi sh'përputhje edhe tek shërbimet e avokatores në vitin 2017 kanë qenë 129,000.00 € kurse në vitin 2018 kemi 1,122.00 €. Shërbimet e kontraktuara të tjera në vitin 2017 kanë qenë 1,428.000 €, kurse në vitin 2018 kemi 7,184.00 €. Në faqe nr.15 nuk janë paraparë mirëmbajtja e ndërtësave, shkollave, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, pyetje ime është pse nuk janë paraparë. faqe nr.18 i kemi shpenzimet ne udhëtimit brenda vendit janë 12,611,20 €, kjo shumë më duket goxha e madhe, shpenzime të telefonit i kemi rreth 5,922.48 €, ndërsa shpenzimet postare janë diku rreth 8,896.00 €, kur i kemi parasysh shifrat e vitit të kaluar e bëjmë një krahësim pse mundet të ndodhë dhe pse nuk mundet të ndodhë. Ajo që më ka ardhur më interesantë mua është shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve, shuma prej 29,457.06 € kjo është një shumë tepër e madhe dhe nuk e di se sa makina janë këtu që duhen aq shumë të mirëbahen, kurse mirëmbajtja e shkollave është 6,189.00 €, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është rreth 23,000.00 €, mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore 15,712.00 €. Paramandoni tani makinat kanë bërë kosto të mirëmbajtjes më shumë se mirëmbajtja e shkollave apo rrugëve, kërkoi një sqarim për këto pyetje nga drejtori.

Kryesuesi – Edhe unë kam dashur një sqarim sa i përket shpenzimeve të asamblesë, ku drejtoi më ka sjellë një raport, edhe unë e di se ne së bashku me kuvendarë për këtë 6 mujor të këtij viti kemi mundur vetëm ndonjë kafe të pimë bashku dhe asgjë më shumë, por besoj se drejtori do na jepe sqarim për këtë.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderoj Drejtorin e Financave që na ka ofruar këtë raport financiar për 6 mujorin e viti 2018. Nëse ndalemi tek të hyrat vetanake edhe unë pajtohem se me të vërtet është një disproporcionalë mes të asaj se sa planifikohet për këtë vite dhe asaj sa është realizuar, edhe në vitin e kaluar ka qenë kështu situata por edhe tani vazhdon të jetë njësoj, kishte me qenë mirë që ne për vitet në vijim të mos bëjmë planifikime nëse nuk mundemi të bëjmë realizimin, është mirë që të planifikohet përafërsisht ajo që do mundemi të realizojmë. Në faqe nr.5 gjobat e trafikut, e shohim se këtu ka një rritje

të realizimit në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa tek gjobat e gjykatave kemi rënje në krahasim me vitin e kaluar. Por nëse e shohim në fund të përqindje në bazë të asaj se sa ka qenë e planifikuar për vitin 2017 dhe sa për vitin 2018, mundemi të konstatojmë se në përqindje ka rrënje të realizimi të hyrave, gjithmonë flasë në bazë të planifikimit. Do të diskutoj pak rreth realizimit të hyrave janar – qershori sipas kodeve ekonomike, kodi 50407 qiraja, vendosja e objekteve tregtare, në vitin 2017 kanë qenë 74,714.10 €, kurse tani ka rrënje goxha të madhe ku shuma është 30,305.52 €, kishte me qenë mirë të na tregoj drejtori pse ky ndryshim kaq i madh. Në këtë vite është duke u parë se në taksën e tatimin në pronë ka një rritje dhe kjo është mirë që të vazhdohet edhe në ditët në vijim sepse nëse vazhdohet kështu mundemi që ti realizojmë edhe projektet e paraparë për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Pastaj në faqe nr.7 shkruan vlera e faturuar në vitin 2016, mos është bërë ndonjë gabim sepse mendoj se duhet të jetë 2017, nëse është gabim le të përmirësohet. Në faqe nr.11 raporti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike janar - qershori 2017-2018, tek shtylla e parë e kësaj faqe ceket buxheti i planifikuar për 2018, propozoj që kjo fjali të përmirësohet dhe të shkruhet: Buxheti i planifikuar për vitin 2018, mendoj se kjo fjali është më e drejtë. Pastaj edhe kolegët e përmendën që kemi shpenzime enorme në vitin që jemi në krahasim me vitin e kaluar si tek zyre Kryetarit ashtu edhe tek të tjerët, besoj se drejtori do na jepe sqarime pse kanë ndodhur këto shpenzime, kur jemi tek ky diskutim do i thosha drejtorit se është dashur që të i ndajë shpenzimet, obligime që janë paguar nga viti 2017dhe ato nga viti 2018 të kishin qenë të ndara, në mënyrë që të dihet se sa shpenzime janë bërë në vitin 2018 dhe sa shpenzime janë bartur nga viti 2017 në mënyrë që ne si anëtar të Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit të kemi të qartë. Në faqe nr.18 tek shpenzimet e varrimit kodi 13410, pyetja ime është: Me çfarë rregullore financiare këto shpenzime janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pastaj në faqe nr.19 kodit 14032 mirëmbajtja e rrugëve lokale, është një vlerë prej 15,712.90 €, pyetje ime është: A ka pasur për këtë procedurë të prokurimit apo nuk ka pasur. Pastaj në faqe nr.20 është mirë të na sqaroj drejtori për shpenzimet në mallra dhe shërbime për vitin 2017-2018, ku është një diferençë prej 162,762.00 €. Do të ndalem pak edhe tek raporti vjetor i nënshkrimit të kontratave publike, faqe 23 kodit 011 ndërtimi i rrugës Krushë e Madhe – Randobravë, meqenëse janë dy fshatra që gravitojnë dy Komuna të ndryshme, pyetja ime për Drejtorin e Shërbimeve Publike është: Randobrava i takon Prizrenit ndërsa Krusha e Madhe Rahovecit, për këtë kontratë a keni bërë ndonjë memorandum mirëkuptimi në mes këtyre dy Komunave për rregullimin e kësaj rruge, apo këtë projekt do e financoj ndonjë ministri. Po ashtu në faqe nr.23 kodit 014 furnizimi me rekuizitat sportive për shkolla ku sete një shumë prej 22,755.00 €, mua më intereson se kush ka qenë kërkuesi i këtyre. Faqe nr.24 tek kodit ndërtimi i serave me participim 80% me 20%, këtu është një shumë me vlerën prej 350,000.00 €, pyetje ime është kjo shumë a është për kontratë një vjeçare apo për më shumë vite dhe nëse është për më shumë vute, pyetje ime është: Sa është planifikimi buxhetor për vitin 2018 për ndërtimin e serave me participim. Për fund mendoj se ky raport është i mirë edhe pse ka mundur të jetë edhe më i mirë, nëse e krahasojmë me vitet paraprake këtij rapporti i mungojnë disa tabele që kanë qenë në raportet e viteve të kaluara, këtë minden ta vërtetojnë edhe kolegët të cilët kanë qenë kuvendarë edhe vitet e kaluara, nëse është e nevojshme ja ceki drejtorit se cilat janë ato tabela, ka mundur drejtori të cekë se sa kanë qenë të hyrat për një kod sipas muajve në mënyrë që të kemi informata më të detajuar.

Afrim Limani – Të nderuar me të vërtet keni bërë shumë pyetje, e them këtë me arsyetimin se nëse nuk kam mundur që të i regjistroj të gjitha pyetjet, keni të drejtë që të i përsëriteni pyetjet në mënyrë që të ju përgjigjem të gjitha pyetjeve. Po ja filloj nga znj. Mirjeta Krasniqi. E nderuar në vitin 2018 figuron një shumë prej 1,350.00 € për shërbime të ndërlidhjes intelektuale këshillëdhënëse, nga këtu i paguajmë mëditjet anëtarëve të KKSB-së, po ashtu edhe disa komisioneve të ndryshme. Shuma prej 3,937.00 € janë për shpenzimet e fotokopjeve jo marketing, planifikimi i buxhetit për vitin 2017 të gjitha shpenzimet e fotokopjeve janë të planifikuara në kuadër të këtij kodit, çdo shpenzim për fotokopje bëhet nga ky kod. Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, ky është shpenzim që është bartur nga viti i kaluar dhe jo

rastësishët të thash se unë dhe ti kemi hëngër dreka këtu, pra ky shpenzimë është bartur në vitin 2018, këtë e arsyetoj sepse ka qenë në fund të viti fiskal dhe nuk ka pasur si të paguhet. E nderuara znj. Shqipë Kryezi i bëri disa pyetje, e nderuar në fillim të raportit ju ceka që e kam përgatit një tabelar i cili mendoj është shumë transparent ku i kamë bërë të gjitha klasifikimet dhe ndarjet e shpenzimeve të bartura nga viti 2017 dhe shpenzimet nga viti 2018. E nderuar shpenzimet e mobileve janë kryesisht bankat e shkollave, pra pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kod janë nga blerja e bankave për shkolla, nuk e përjashtoj që edhe ne e kemi bërë një pjesë të shpenzimeve sepse ka pasur nevojë për furnizim të zyrave. Sa i përket shpenzimeve të karburantit dhe mirëmbajtja e makinave, kjo pyetje ishte bërë nga shumë kuvendarë, shpenzimi i vitit 2017 ka qenë 13,730.00 €, ndërsa shpenzimi i vitit 2018 është 29,457.00 €, ne e kemi bartur borxh nga 2017 diku 14,474.00 €, kurse ne kemi krijuar shpenzime përafërsisht të njëjtën vlerë. Do i përgjigjëm një pyetje që secili kuvendarë e ka bërë, pse është shpenzimi i buxhetit këtë vit më i lartë ndërsa vitin e kaluar ka qenë më i vogël. Esenca e çdo organizate buxhetore është shpenzimi në raport me planifikimin, pora në një përqindje sa më të madhe, ne kemi arritur që të gjitha shpenzimet e krijuara të kësaj qeverie aktuale të i paguajmë dhe ne sot absolutisht nuk i kemi borxh askujt sepse pagesat janë bëtë me kohë dhe kjo është arsyaja pse janë rritur shpenzimet. Nuk dua që ti kritikoj qeverisjen e kaluar por ata për një apo shumë arsyë nuk kanë mundur që të bëjnë shpenzim të buxhetit, ne jemi në fazën e 6 mujorit dhe realisht buxheti duhet që të shpenzohet realisht 50%, pse nuk kanë bërë ata shpenzim kanë pasur arsyë p.sh shpenzimet e telefonit e di që nuk ju kanë shkuar saturat me kohë dhe ata nuk kanë mundur që të bëjnë këtë shpenzim të buxhetit. Por pyetje juaj është besoj se ne duhet që të kursejmë buxhetin në disa kategori të ndryshme, p.sh buxheti duhet që të kursetet në dregat zyrtare, pastaj në furnizimit të zyrave, ky shpenzim është për blerje të letrave dhe materialit administrativ që na nevojitet për zyre, pra edhe këtu duhet të mundohemi që të kursejmë buxhetin. I nderuari z. Vahid Krasniqi besoj se ta kam dhënë përgjigjen ashtu siç të kam premtuar sa i përket mirëmbajtjes së makinave, ndërsa në detalet ne nuk mundemi në raport që ti fusim se sa ka shpenzuar një veturë, ne mundmi ta bëjmë sepse ne të gjitha shënimet i kemi por duhet një punë e madhe për këtë dhe besoj kjo informatë nuk është e nevojshme. Znj. Florida pyeti për shpenzimet sa i përket furnizimit të zyrave, për këtë ja dhashë përgjigjen pak më parë. I nderuari z. Masar Popaj është e vërtet që ka një dallim negativ prej 44,000.00 € sa i përket të hyrave nga qiraja e vendosjes së objekteve tregtare, i nderuar kush ka qenë kuvendar e dinë pse ka ardhur deri tek kjo sepse në mandatin e kaluar është mare vendim që kjo taks të zbritet në masën prej 50% çdo biznesi që shfrytëzon qira me kusht që bizneset ta paguajnë borxhin e mbetur. Z. Ali Zhuniqi nuk kam mundur që ti shkruaj të gjitha pyetjet që i parashtronte, por disa prej tyre besoj se i ke mare përgjigje sepse janë përsëritur nga koleget e tjera.

Ali Zhuniqi – Tek furnizimi me pije e the edhe ti se duhet që të bëhet një térheqje e shpenzimeve për arsyë të ndryshme, konkretisht tek tabela 3.4 raporti për mallra dhe shërbime kod 13620, këtu paraqitet një diferençë në krahasim me vitin e kaluar rrëth 3,925.00 € dhe nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kjo për mua paraqet një pasqyrë jo reale. Po ashtu edhe tek shpenzimet e veshmbathjes vitin e kaluar nuk ka pasur fare shpenzime, ndërsa këtë 6 mujor të vitit 2018 janë bërë shpenzime diku rrëth 4,483.00 €.

Afrim Limani – i nderuar sa i përket shpenzimeve të veshmbathjes Drejtoria e Inspektoratit ka pasur një planifikim buxhetor përfurnizim me rroba përfundëtorët e vetë, prandaj është krijuar ky shpenzim, pra këto shpenzime janë bërë kryesisht përrrobat e fundëtorëve të drejtorisë së inspektoratit. Sa i përket shpenzimeve për ushqim dhe pije, këtu kemi të bëjmë me vetëm përujin që e pimë si ne ashtu edhe shkollat e Komunës të Rahovecit, ata kanë aktivitete të shumta dhe ne duhet që ti furnizojmë së paku me ujë të pjesë. Pastaj aktivitete të shumta ka edhe Drejtoria e Urbanizmit dhe këto shpenzime kryesisht këtu janë bërë, mos harroni se një shishe me ujë ne e marrim me çmim prej 0.25 € këtë kontratë ne e kemi gjetur. Znj. Florije Boshnjaku është e vërtet se planifikimi dhe mundësia e realizimit ka një dallim të madh këtë e kam parë edhe unë, kjo është bërë nga detyrimi nga MF që të bëhet një planifikim më i madh dhe përkëtë arsyë ata i kanë fryrë disa pozicione dhe disa kategori. Unë së bashku me stafin e Drejtorisë

së Financave e kemi bërë një analizë shumë të mirë dhe besoj se planifikimi do të jetë real. Sa i përket kodit 50201 në bazë të analizave të mijës ky është një planifikim real shuma prej 400,000.00 €, sepse ata kanë menduar që qytetarët përmes një ligji që pritet të vije për aplikim për licencim të objekteve të banimit. Z. Fehmi Cena i bërë disa pyetje, sa i përket taksës për legalizim të objekteve besoj se ju përgjigja pak më parë znj. Florije, sa i përket çështjes së komisionit për dhënien e certifikatave për marrje të patentë shoferit, për këtë kam biseduar me Drejtorin e Shëndetësisë dhe besoj që brenda këtij vite nëse na lejojnë rregulloret dhe ligjet do të bëjmë diçka. Pastaj arsyesa pse nuk figurojnë në tabelar donacionet, në tabelarin e fakes nr.11 janë të pasqyruara vetëm shpenzimet e buxhetit, i nderuar çdo gjë bëhet përmes sistemit, e di sigurte që ne një donacione e kemi fituar në vlerën prej 195,000.00 €, por ato mjete ende nuk figurojnë në sistemin dhe në xhirollgarinë e Komunës, në momentin kur hynë në kodin 623 i cili kod është i Komunës së Rahovecit, pastaj atë automatikisht e regjistron sistemi, pastaj ne raportin e nxjerrim në bazë të sistemit. Z. Dervish Çadraku pyeti pse nuk ka taks për leje ndërtimi këtë vite, i nderuar nuk ka sepse nuk kanë aplikuar për leje ndërtimi në këtë 6 mujor, sa i përket asaj pse nuk ka të hyra nga gjobat e inspektoratit, të hyrat e inspektoratit kryesisht janë nga gjobat e gjykatave dhe në raport i kishit gjobat nga gjykata me shumën prej 15,000.00 €. A i përket shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit, këto shpenzime kryesisht janë bërë bartja e nxenësve nga vendbanimet e tyre në shkollë dhe anasjelltas. Z. Rasim Fazliu besoj se disa përgjigje i more, kurse sa i përket pyetjes si janë bërë pagesat e shpenzimeve të varrimit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ne shumë herë e kemi diskutuar këtë çështje sepse auditori në vitet e kaluara e ka nxjerrë keq Komunën e Rahovecit si rezultat i pagesës së shpenzimeve të varrimit nga kategoria e subvencioneve të Kryetarit, pas sugjerimeve nga auditori ne kemi bartur një borxh prej 18,000.00 € dhe sipas rekomandimeve të tyre ne jemi detyruar që këtë pjesë të borxhit që e kemi bartur ta paguajmë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, tash e tutje këto pagesa do të bëhen nga ky kod. Më duket se i mbete borxh z. Cena një pyetje rreth mirëmbajtjes së objekteve shëndetësore ku vlera e shpenzimeve është diku 23,000.00 €, i nderuar këto shpenzime që paguhet për shërbime të pastrimit të kompanisë e cila ka kontratë të lidhur me ne.

Fehmi Cena – A është paraparë mirëmbajtja e objekteve ekzistuese si lyerje dhe renovim sikurse në shkolla që është duke u bërë, pak më parë i përmenda shqetësimet tonë rreth pastërtisë në këtë institucion, ka gropë që janë hapur par disa vite dhe këtë vite ato vetëm janë rritur, ka pasur kërkesa nga ne që ato të rregullohen dhe të pastrohen në mënyrë që ne të kryejmë punën ashtu siç duhet, nëse nuk janë paraparë brenda këtij 6 mujori të parë, kishte me qenë mirë që brenda 6 mujorit të dytë të ndërhyhet në këtë objekt ku më së shumti punohet me disa renovime, sepse me të vërtetë ky objekt ka nevojë për ndërhyrje.

Afrim Limani – Kjo pyetje është komplet tjeter dhe për këtë mundësh të bësh një kërkesë Drejtorit të Shëndetësisë dhe besoj se do të ketë kontratë për mirëmbajtje të objekteve. Gjithsesi këtë mesazh edhe unë do ja barti Drejtorit të Shëndetësisë. Z. Rasim Fazliu sa i përket shumës për mirëmbajtje të rrugëve lokale, i nderuar ky shpenzim është krijuar për pagesën e ambientit, ne e kemi një kontratë brenda viti diku rreth 70,000.00 € dhe ne e paguajmë këtë kompani për shërbime që i kryen brenda Komunës së Rahovecit.

Përparim Krasniqi – I nderuari z. Rasim rruga Krushe e Madhe – Randobrav është e lidhur kontrata me kompaninë Mendi – P, vlera e kontratës është rreth 444,000.00 €, i gjithë ky projekt është i mbështetur nga Ministria e Infrastrukturës, Komuna e Rahovecit nuk ka të bëjë asgjë me financimin e këtij projekti. Po ashtu po ju informoj për projektin e meremetimin e rrugëve, është risi për herë të parë se meremetimi i rrugëve do të ndodhë në tre lloto, me asfaltim, kubëza dhe me mure mbrojtëse, kontrata është tre vjeçare.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj fale që nuk pata mundësi të vijë që nga fillimi i mbledhjes, sepse pata një takim po aq të rëndësishëm sa është edhe kjo mbledhje. E dëgjova me vëmendje përgjigjet e drejtorit, po ja filloj me pyetjen sa i përket asfaltimit të rrugëve Krushë e Madhe – Randobrav, pas 10 minutave do shkoj që të përruroj fillimin e asfaltimit të kësaj rruge, për vlerën e kontratës më duket ju tregoi drejtori, është një rrugë me standarde, një rrugë që i lidhë dy vendbanime

dhe besoj se në afatin optimal të parapamë do të ndërtohet një rrugë e jashtëzakonisht e rëndësishme. Sa i takon kontratës për sera nuk jam shumë i sigurt, ndoshta drejtori i ka informatat më të sakta, por ajo që e di është se kjo kontratë do të jetë 2 vjeçare, e di që ka ri tenderim të, kjo kontratë është e lartë dhe besojmë se me kornizën afatmesme buxhetore 2019/2021 do të nënshkruajmë kontratën, nëse këtë vite p.sh janë 80,000.00 € atëherë për vitin 2019 duhet që ti planifikojmë edhe 120,000.00 €. Kjo kontratë do të ketë një dallim në krahasim me vitet e kaluara, do të ketë sera me sipërsfaqe prej 1.5 ari, 3 ari dhe 5 ari. Besoj se kjo do të jetë një traditë e mirë që dëshmon përkushtimin e Komunës së Rahovecit në drejtim të përkrahjes të fermerëve në pozicionin e serave. Këtë ujë që po e pimë sipas drejtorit të financave i blejmë 0.225 €, ndërsa për zyrën e Kryetarit ishin disa shishe të qelqit që kushtonin 0.50 €, këtë kontratë e kemi trashëguar, unë me ekipin time e kemi rregulluar këtë punë dhe jemi duke e mbushur shishet me ujë të radoniqit, ndërsa për anëtarët e kuvendit nuk jemi duke bërë këtë, kjo ishte pak për relaks. Kontratat shpesh herë kur nënshkruhen me Komuna ato pozicione ku ka kërkesa më së shumti janë pozicionet jashtëzakonisht të shtrenjta, kemi kontrata të tilla edhe me servisime dhe mirëmbajtje të automjeteve, ne kemi kontrata të tilla edhe me furnizim me piye ose rekuizita sportive, këta që marrin pjesë në këtë konkurrencë dhe kur konkurrojnë në këto projekte dhe kur e dinë diçka që është duke u kërkuar shumë gjithmonë e ngrisin çmimin, besoj se të gjithë jeni dakord me këtë që e thash, por janë çështje që më së mirë i dinë zyrtarët e prokurimit. Paramendoni ne kemi kontratë që 4 goma për makinë zyrtare që kushtojnë 480.00 €, nëse do të ishin goma për ndonjë automjet të blinduar isha pajtuar por janë goma të thjeshta, këto kontrata Komunën tonë dhe Komunat e tjera të Kosovës i kanë përcjellë në vazhdimësi, do mundohemi që të jemi korrekt në të ardhmen, për këtë nuk është fajtor as Kryetari i kaluar dhe as Kryetari i tanishëm. Pra desha të ilustroj se pse ndonjëherë shkojnë aq lartë shpenzimet, unë kam shkuar deri në atë pikë ku ju kam than drejtorëve mbyllni makinat mos dilni fare dhe mos i servisoni, për arsy se dimë ne sa do të na kushtoj një servisim. Kursimi në pozicionet e ndjeshme është i domosdoshëm, pastaj ekonomizimi i shpenzimeve është i domosdoshëm, darkat dhe drekat janë të domosdoshme kur duhet të janë të domosdoshme, natyrisht edhe ekonomizimi i këtyre shpenzimeve është i domosdoshëm kur kemi mundësi.

Rasim Fazliu – Faza e tretë e ndërtimit të palestrës sportive është mirë që është nënshkruar memorandumi, por pyetja ime është: Sa përqindje i mbulon shpenzimet ministria dhe sa Komuna.

Kryetari – I nderuar z, Rasim Fazliu, është fat shumë i mirë që palestra sportive në Rahovec mbështetet 100% nga Ministria e Kulturës, rinis dhe porteve nga financat e buxhetit të shtetit, ne jemi në fazën e 3 përmbyllëse dhe përfundimtare, në momentin kur i prehet shirit asaj palestre hairin ja pafshim qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe ekskluzivisht e gjithë përgjegjësia në çdo pozicion i takon pastaj Komunës së Rahovecit. Kontrata e cila është nënshkruar është mbi 628,000.00 € nga vlera e parashikuar që ka qenë mbi 899,000.00 €. Së bashku me kryesuesin e kuvendit ju kisha ftuar që të shkoni që ti vizitoni punimet në këtë palestër dhe në këtë mënyrë ndoshta do i shihni edhe të mirat por ndoshta edhe ndonjë defekt që ka mundur të përcillet nëpër fazat e mëhershme dhe që tani detyrohet operatori që ti riparoj, për arsy se gati 2-3 vite aty kanë pushuar punimet. Kryesorja që punimet janë duke vazduar tani dhe besoj se do të kemi një përmbyllje brenda këtij viti.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar rreth pikës së tretë, kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017.

Afrim Limani - Drejtori Limani po ashtu prezantoi para anëtarëve të Kuvendit Raportin e zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 për Komunën e Rahovecit. Sipas drejtorit Limani ky raporte është kualifikuat si raporte i kualifikuar, që do të thotë raport negativ për Komunën e Rahovecit, drejtori i ceku një nga një të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit të jashtëm.

Florije Boshnjaku – Lidhur me këtë raport e ceku edhe Drejtori për Financa ku raporte është klasifikuar si raport i kualifikuar që do të thotë si raporte negativ, nëse lëshohemi në thelb ne nuk mundemi as të kritikojmë por as të lavdërojmë qeverinë e kaluar, por realiteti është se ky raport ka dalë negativ. Pyetje

ime për drejtorin është: Shpenzimet që janë bërë nga mallrat dhe shërbimet edhe nga subvencionet të cilat janë mare nga investimet kapitale, në këtë vite a do të bëhen nga kodi për investime kapitale apo nga mallrat dhe shërbimet. Pastaj kur bëhet fjalë për regjistrim të aseteve si ato të luajtshme po ashtu edhe ato të paluajtshme, edhe më herët por edhe ky mandat dhe tjetri që do vije ne do të kemi prapë këtë problem, këtë problem e kanë të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës. Ne në Kosovë kemi shkolla ambulantë dhe institucionet publike të cilat janë të ndërtuar me një vend ku pronar nuk është Komuna e Rahovecit, prandaj e lusë qeverinë aktuale që të sheh se ku janë të vendosura institucionet publike, të shpallin interesin e përgjithshëm dhe të bëjnë regjistrimin e të gjitha aseteve në mënyrë që vitin tjetër ky raporte të jetë i pakualifikuar ose i pamodifikuar.

Mirjeta Krasniqi – Pajtohem me fjalimin e parafolëses, desha të ndërlidhem sa i përket nr.6, konkretisht në faqe nr.19, ku ceken dobësitë për ndarjen e subvacioneve, ku si të gjetur e kanë cekë pagesën në xhirologari private, fjalë është për pagesën për shërbime të varrimit dhe jo në llogari të BIK-ut, pasi që BIK-u nuk paska pasur llogari të hapur. Pastaj diçka tjetër që dua të shtoj është një keq formulim ose keqinterpretim tek çështja e 6 sepse këtu ceket se zyra e gjendjes civile duhet që ti përmirësoj listat e personave të vdekur, mendoj se këto lista duhet që të pastrohen e jo të përmirësohen dhe kjo të bëhet nga MPB, respektivisht agjensioni për regjistrim. Për çregjistrim të personave të vdekur duhet ta bëjnë familjarët në afat prej 30 ditësh nëse jo atëherë do të gjobiten, për të shmangur këtë problematic mendoj se kur të bëhet pagesa nga drejtoria përkatëse për shërbime të varrimit, duhet që të kërkoj certifikatën e familjarit të vdekur dhe jo të mjaftoj rapporti që vije nga BIK-u. Kështu do të kemi një praktik të mirë dhe do të filloj të pastrohet lista e të vdekurve. Ka shumë të gjetura të tjera dhe ne e dimë që ky raport është për vitin 2017, por dua që të ndalem edhe tek çështja nr.12 sepse tek auditorët ka shumë dobësi. Faqe nr.25 ceket se auditorët e brendshëm duhet që ta kryejnë punën e vetë me shumë përgjegjësi të madhe dhe pastaj të na vinë me raporte relevante, po ashtu dua ta di a është i formuar Komiteti i Auditimit, pasi që në vitin 2017 nuk ka qenë fare efektiv.

Fahrije Lushi Morina – Ato që i përmendën parafolësit t' mijë janë të ndërlidhura ma ato që do të diskutoj edhe unë, para vete e kemi një auditimi i cili i takon vitit paraprak 2017, konkluzionet dhe rekomandimet janë duke u parë qartë që shpërfaqin të metat dhe mangësitë brenda përbrenda një auditimi, fjalë bie për pasqyrat financiare njëra ndër çështjet më të ndjeshme. Sa i përket pasqyrave financiare auditorët e kanë cekur se nuk janë përgatitur me kujdesin e duhur, duke ju konsistuar gabimeve materiale e cila ka ndikuar drejtpërsëdrejti në opinionin e auditimit, këtu thuhet se mangësitë e theksuara janë gjetur edhe në fushën e shpenzimeve të hyrave, prokurimit, në menaxhimin e personelit, monitorimin e subvacioneve, po ashtu edhe në menaxhimin e pasurive. Procesi i zbatimit të rekomandimeve nuk është adresuar ashtu siç kerkohet për zhvillimin edhe përmirësimin e organizatës si tërësi. Nëse këto janë të meta të cilat i takojnë auditimit të vitit të kaluar, qeverisja e tanishme a do të ketë diçka të veçantë ose a do të ketë ndonjë plan të veprimit në mënyrë që mos të hasim më në këto mangësi.

Dervish Çadraku – Ky gjysmë viti na ka shkuar me auditime të kaluara, përpos raportit 6 mujor që ka qenë nga kjo qeverisje. Gjatë leximit të këtij materiali jam përpjekur që ti paraqes në disa pika dobësitë të cilat i ka gjetur auditori i jashtëm për punën e qeverisjes së viti 2017. E para nuk është evidente që nuk evidentohen pronat e paluajtshme, pastaj dosjet e punëtorëve të pakompletuara, kemi mos pagesë të qirasë nga bizneset, lidhje të kontratave pa procedurë të prokurimit, hyrja në obligime, në vend që 210,000.00 € del 546,868.00 € mjetet të sigurara ndërsa të tjerat kanë qenë të pasiguruara, pastaj menaxhimi i dobët i pasurisë, jo evidentimi i pasurisë së Komunës, rritja enorme e obligimeve të bartura të Komunës me vlerë 2,243,767.00 €, mos evidentimi i obligimeve si ajo e 24,795.00 € të kanalit të ujërave të zeza, me të vërtet si duket ka një kokëfortësi ose një mospërfillje të rekomandimeve të auditimit që mundëson që lëshimet të mos përsëriten më. E para ishte nuk evidentohen pronat e paluajtshme të Komunës, nëse nuk do të bëhet evidentimi i tyre me siguri që do të kemi edhe probleme me të hyra sepse këto prona prodhojnë të hyra, e gjitha kjo shkon në dëmin e Komunës. Ne kemi s'ter

ngarkesë të stafit civilë në Komunë ndërsa punët po mbesin të pakryera, paramendoni dosjet e punëtorëve nuk kanë certifikata të lindjes, nuk kanë letërnjoftime, pra të gjitha gjërat që duhet të i ketë një dosje nuk i ka. Pastaj ceket se kemi kontrata të lidhura pa procedurë të prokurimit, kjo është rreptësishtë e ndaluar, shpresoj se tani nuk do të ndodhin këso gjëra sepse edhe më parë kanë ndodhur këso gjëra, nëse do të ndodhë prapë kështu atëherë buxheti i Komunës do të ketë humbje. Pastaj e gjetura e radhës është hyrja në obligime, e dimë që është antilogjore por po ashtu e dimë se kështu është vepruar edhe në mandatin e kaluar por edhe para atij mandati, qeveritarët e kaluar kanë hyrë me këso obligime por para qytetarëve kanë qenë bukur joshës, sepse qytetarit të thjeshtë nuk i ka interesuar se ka i merë mjetet por atij i intereson që të ketë rrugën e shtruar dhe kanalizimin e ngritur, por me këtë është dëmtuar buxheti i Komunës dhe operatori sepse edhe operatori është hy në kurth duke menduar se do të bëjë diçka por më vonë nuk ka mjetet për t'ju paguar dhe ai mbetet keq dhe dështon. E gjetura e radhës është jo evidentimi i pasurisë, qe nga pas lufta kjo punë është dashur të bëhet por nuk është bërë, nëse nuk e bënë evidentimin e pasurisë atëherë ti nuk e njeh fuqinë tënde si ato ekonomike dhe fuqitë e tjera, mua më çudit fakti pse kjo punë nuk është duke ndodhur, pasuria e Komunës duhet që të evidentohet dhe të futet në letër, pastaj të menaxhohet dhe të dihet se nga po shkon. E gjetura e radhës është rritja enorme e obligimeve të bartura, kjo e dëmton shumë Komunën edhe kjo ka ndodhur edhe në të kaluarën dhe po ashtu para kësaj qeverisje, pra deri në 2,243,767.00 € ka obligime për ti paguar kjo qeverise, sipas logjikës kjo qeverisje tani të mos punoj asgjë por vetëm të i paguaj këto borxhe, pastaj të ja filloj me investime kapitale për qytetarët e Komunës sonë. Shpresoj shumë se ju nuk do i merrni shembuj nga qeverisjet e kaluara dhe të mos i përfillini rekomandimet e auditimit, sepse siç e pashë qeverisje e kaluar vetëm në një ose dy vende i ka përfill rekomandimet e auditimit, kurse të gjitha të tjerat janë të papërfillshme ose janë injoruar dhe kjo gjë është shumë praktik e keqe dhe shumë e dëmshme për qytetarët. Paramendoni nuk kanë pasur mundësi që të ja paguajnë BIK-ut pagesën në xhirollogari sepse nuk kanë pasur aktive, kur lidhet marrëveshja me një institucion së pari ai institucion duhet që të ketë xhirollogari, nëse nuk e ka atëherë nuk duhet që të bëhet as marrëveshja, çuditem se si i kanë bartur mjetet tek personi fizik, kur ai person mundet që ti keqpërdorë ato mjetet, ai ndoshta është burri i mirë nuk dyshoj por logjikisht dhe ligjërisht kjo është rreptësishtë e ndaluar. Uroj që kjo qeverisje të i ketë parasysh këto rekomandime dhe shpresoj se vitin e ardhshëm nuk do të kemi këso probleme dhe kaq kualifikime të dobëta të Komunës.

Rasim Fazliu – Në raporte të auditorit të përgjithshëm kemi për çdo vit thaujse vazhdimisht si në qeverisjen e kaluar ashtu edhe në qeverisjet e mëparshme janë duke iu përsëritur gjërat nga viti në vit. Pajtohem po ashtu me parafolësit që të eliminohen këto probleme që i ka paraqitur auditori në mënyrë që mos të na përsëriten të njëjtat probleme edhe pse auditori këtë punë e ka dhe do e shihni se edh në vitin e ardhshëm do të kemi vërejtje nga auditori, por ashtu siç tha edhe Drejtori i Financave është mirë që të organizohemi të gjithë në mënyrë që në vitet në vijim të kemi sa më pak vërejtje nga auditori i përgjithshëm. E kam analizuar këtë raport dhe të gjeturat nuk mundemi askush të i humbim dhe nuk ka nevojë askush që të arsyetoj, po ja filloj nga faqja nr.4 jam duke parë që në fillim këtu ka një mospërputhje sepse konstaton se: Pasqyrat financiare vjetore për vitin 2017 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale etj. Ndërsa në faqe nr.5 tek konkluzionet dhe rekomandimet kryesore ceket se pasqyrat financiare, kualifikimi i opinionit dhe theksimi i çështjes tregojnë se pasqyrat financiare nuk ishin përgatitur me kujdesin e duhur dhe përbëjnë gabime materiale të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit, këtu po shoh një kontradiktë tani ose janë të përgatitura mirë ose nuk janë, auditori këtu siç duket ka bërë një lëshim, shkojmë tek faqja 10 ku thotë se Drejtori i Financave në mënyrë ligjore është e ndaluar të i nënshkruajë pasqyrat financiare mirëpo çuditërisht i dinë gjërat dhe i bëjnë në qoftë se ka qenë me ligj e ndaluar ajo punë unë nuk di pse kanë vepruar ashtu, tash nuk e kam hallin për të kaluarën por për të ardhmen nuk e di kjo Qeveri tash a ka angazhuar ndonjë zyrtar për të i nënshkruar këto pasqyra kështu që mos ta lëmë për vitin e ardhshëm të përsëritet kjo çështje prapë, kemi këtu tek faqe 16 ka qenë vonesa e qirasë së paku ne që jemi asamblistë më të vjetër këtu e

kemi të qartë se vërtetë janë bërë disa përpjekje dhe angazhime, i kemi shtyrë afatet meqenëse Qeveria Qendore mori për obligim të i paguajë disa shpenzime qirasë ne jemi munduar të bëjmë çdo gjë që është e mundur, nëse e krahasojmë prej vitit 2013-2017 është bërë një përparim në këtë drejtim por nuk do të thotë që është kryer e gjithë puna duhet ende të punohet në këtë drejtim në mënyrë që qiraja të mblidhet në kohë sepse është shumë me rëndësi tek shpenzimet e varrimit është ashtu por ne e dimë qe nuk kemi mundur që si Qeveri kushdo qoftë të kishte qenë të bëjmë pagesën ndryshe sepse nuk ka pasur ka qenë mungesë e ligjit, tani ka dal ligji për bashkësitetë fetare nuk e di a është aprovuar apo ende jo por që ju jep të drejtën atyre për të hapur llogarinë e vete bankare e të tjera për të i bërë pagesat mirëpo në pamundësi sepse nuk kanë pasur të drejtë ligjore ata të i hapin xhirolllogarinë e vet ne si Kuvend Komunal kemi marrë qëndrim që të ju ndihmojmë familjarëve të gjithëve që kanë raste vdekjeje të ju mbulohen shpenzimet e varrimit edhe tash Komuna është e obliguar në njëfarë mënyre ta bëjë pagesën, pa dashur të i arsyetoj apo jo por në mungesë të ligjit nuk kanë mundur të shkojnë me procedurë të rregullt e tash pasi që është ligji mund të shkohet dhe të bëhet pagesa ashtu siç i ka hije, tek obligimet kontraktuale pa mbulesë buxhetore unë mendoj që edhe në qeverisjen e kaluar edhe në qeverisjet e kaluara qoftë se e marrim edhe në vitin 2014 etj d.m.th ka pasur obligime të atilla mirëpo qeverisja që pason tanimë duhet ta gjejë rrugën mënyrën edhe metodën si të vihet deri tek ajo që ato kontrata që kanë qenë të zbatuara me i përfillë dhe të vazhdohet tutje, kështu është puna qeveritë ndërrohen edhe ai që vjen e vazhdon punën e tjetrit edhe ec puna përrpara, tek regjistrimi i pasurive këto çështje kanë qenë vazhdimisht të ngritura ndër vite dhe janë të papërfunduara bile më kujtohet kur tash drejtori aktual i financave në atë kohë pjesë e kuvendit ishte drejtar se po të isha unë këto çështje do të i zgjidhja për dy tre javë, e unë drejtorit po ja lë në dispozicion një vit vetëm le të mundohet të i zgjidhë, nuk e kam me asnjë qëllim e kam kështu pa qëllime të caktuara por jam për atë që vërtetë pasurinë Komuna duhet ta dijë por kjo pse ka vazhduar që shumë vite kështu unë nuk e di por bile tash e tutje mos të vazhdojë, brenda këtij mandati duhet të dihet pasuria e Komunës dhe të bëhet vlerësimi siç i ka hije e siç duhet, Afrim të përmenda qëllimisht sepse thoshe që për dy javë e zgjidhi tash bile për një vit zgjidhe, këtu kemi vërejtje ka qenë planifikimi dhe procesi i dobët i prokurimit, kjo është cek se ka qenë si pasojë e kontrollit të dobët të menaxhimit por shpresoj që tani po e them edhe njëherë në këtë qeverisje mos të i lejojmë të përsëriten gabimet që janë përsërit në qeverisjet e kaluara, mos të flasim tash për dosje ose për ato që thamë është me të vërtetë papërgjegjësi e imja e tjetrit e tjetrit në qoftë se unë them jo nuk është certifikata lindjes jo nuk është ajo , kjo është përgjegjësi e të gjithë atyre punëtorëve që punojnë në atë sektor kudo qofshin ato prandaj si përfundim nuk po zgjatem më tepër është mirë që gabimet që janë përsërit në qeverisjen e kaluar dhe në qeverisjet tjera mos të bëhen në reportin e auditimit për vitin e ardhshëm që vjen e pastaj në vitin tjetër e kështu me radhë por të shkojmë duke i përmirësuar gjërat edhe na shkon puna siç është më së miri, besoj që qeveria aktuale unë e di që e ka formuar komitetin e auditmit, jemi të informuar për atë punë ishalla është funksional sepse ai e kryen një punë shumë të madhe për mos të ardhur deri tek këto parregullsi.

Kryetari- Faleminderit për mundësinë, **Kryesues i nderuar**, **Këshilltarë të KK**, **Monitorues**, të ju them të drejtën raporti i zyrës kombëtare të auditimit është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm që është e pamundur mos të lexohet me vëmendje secili prej Këshilltarëve të Kuvendit por njëkohësisht edhe Kryetari edhe ekipi i tij, kjo bëhet edhe për një arsy themelore, e para se secili që merr përgjegjësi të administrojë diçka natyrisht ka për qëllim të mësojë nga këshillat që japidh ata që janë kompetent në këtë rast zyra kombëtare e auditimit të jashtëm, edhe unë jam njëri prej atyre që e kam lexuar me vëmendje dhe po përpinqem që me dy tre fjalë të shpjegoj se disa momente të cilat i trajtoi z.Fazliu është e vërtetë që disa prej këtyre Komuna janë lëngon me vite le të themi me 10 ose 15 vite le të themi prej vitit 1999 ose prej kur janë formuar Qeveritë legale dhe Kuvendi Komunal që kanë qenë legale në kuptimin përmes zgjedhjeve, çka më ka rënë në sy edhe ne është dashur ta adresojmë, neve na është dashur tre muaj për të ardhur në shprehje deri tek një raport maksimalisht profesional dhe i bazuar në fakte për regjistrimin e pasurisë, jo dy javë ose tre por edhe unë personalisht kam pasur probleme sepse ky rekomandim ose kjo e

gjetur ka qenë edhe kur kam qenë herën e parë Kryetar i Komunës, edhe në kohën e z.Vehapi, edhe në kohën e z.Qeska, kemi pasur problem me regjistrimin e aseteve, pasurisë, pasurisë me vlerë jo-financiare me vlerë nën 1000€, ky problem besoj që e ka marrë rrugën e zgjidhjes sepse ne e kemi tashmë të prodhuar një dokument i cili tash i mbetet kuptohet zyrtarëve kompetent për herë të parë le të themi edhe këtë e kanë parë veç auditorët e brendshëm, tash është dokumenti i prodhuar dhe mua më është dashur të formoj edhe komisionin për regjistrim, edhe komisionin për verifikim edhe komisionin për vlerësim d.m.th disa komisione të cilat është dashur tre muaj ditë të kalojnë të cilat mezi që kanë arritur ta bëjnë, tash po besoj që ky rekomandim është adresuar dhe po plotësohet edhe besoj që në vitin e ardhshëm nuk duhet të jetë temë, mund të jenë tema të tjera sepse auditorët mund të kenë plot situata që i trajtojnë në kuptimin e ecurisë së ligjshmërisë etj por kjo temë po besoj që nuk do të i jep opinion të kualifikuar raportit të auditorit të jashtëm në vitin e ardhshëm kur bëhet për këtë vit, ne kemi edhe mungesë planesh sipas raportit d.m.th plane vepruese, plane të caktuara, dokumente strategjike por besojmë që në atë drejtim edhe vetë Kuvendi i Komunës ka adresuar disa shqetësime të cilat ngritën nga auditori i jashtëm p.sh plani për menagjimin e mbeturinave apo edhe plane të tjera mos të i përmendim të gjitha, ka edhe plane të cilat ne i kemi bërë si Qeveri Lokale të cilat nuk është e nevojshme të dalin në Kuvend por ka edhe plane të cilat duhet ta marrin aprovin e Kuvendit e problem tjetër i cili është ngritur natyrish janë edhe çështje të tjera të cilat lidhen me çështjet e prokurimit, çështja e mungesës së një zyrtari të lartë financiar që duhet ta ketë Komuna, çështjet që lidhen me mangësitë e funksionimit në Komitetin e Auditmit të Brendshëm, këto rekomandime ose të gjetura ne i kemi shqyrtuar jashtëzakonisht me vëmendje dhe përmes një plani të veprimit efektiv po besoj që rekomandimet do të marrin do të plotësohen dhe raporti i auditorit të jashtëm të shohim tash sepse ne kemi edhe pesë muaj për këtë vit po përpinqemi që raporti i zyrës kombëtare të auditmit, raporti i auditorit të jashtëm, do të vijë me opinion të pakualifikuar të çështjes ka shumë instrumente të cilat neve na mundësojnë që në të ardhmen të gjeturat mos të dëmtojnë interesin publik, unë e di që qdo raport që vjen nga organe kompetente duhet të merret si mësim i vlefshëm për të mos u përsëritur së paku gabimet të cilat janë të qartësuara në të gjetura, në rekomandime e konkluzione të ndryshme, ky raport shpresoj që na ka shërbyer neve që Qeverisja në të ardhmen të ketë argumente të përmirësimit të vazhdueshëm sepse kjo është edhe logjika e një qeverisjeje të mirë por kjo është edhe besoj synim i yni dhe i të gjithëve, kjo është edhe pritja e qytetarëve të Komunës tonë, ne reportin e kemi para vetes e unë si Kryetar i Komunës e kam pasur ndoshta i pari edhe hapat të cilët duhet të ndërmerr nga Kryetari për të i ndryshuar parametrat eventual që i ka ai raport për një vit më herët sigurisht që i ka marrë masat institucionit i Kryetarit të Komunës edhe me ekipin e tij do të kujdesen që në të ardhmen të kemi raporte sa më pozitive nga vlerësuesit e jashtëm, ne i kemi shqyrtuar edhe raportet e auditmit të brendshëm, ka mangësi ndoshta por sigurisht që bashkë me KK si instrument që ka për qëllim të korrigojë dhe të japë vërejtje me qëllim të përmirësimit të punës së qeverisjes ne do të ja dalim mbanë që në të ardhmen të kemi raporte sa më pozitive ose me opinion të pakualifikuar të çështjes.

Kryesuesi- Kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës ,Shqyrtimi i informatës mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së, për këtë pikë ftoj drejtorin z. Rumir Zhuniqi.

Rumir Zhuniqi- Faleminderit Kryesues, i nderuar Kryetar, Nënkyetar, Asamblistë, unë do të paraqes një informatë mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së, Drejtoria për Urbanizëm është duke vazhduar punët rreth hartimit të këtij plani sipas ligjit të ri të planifikimit hapësinor dhe programit të miratuar nga Kuvendi rreth hartimit të këtij plani, ne kemi prezantuar para një muaji një dokument që përbën të dhënat aktuale të Komunës sonë, i kemi paraqitur para komitetit drejtues i cili e mbikëqyr punën tonë rreth hartimit të planit zhvillimor, aty kemi marrë vërejtje, sugjerime, komente rreth hartimit të PZHK-së po ashtu kemi vazhduar me punëtori për secilën drejtori ku kemi marrë planet që ka secila drejtori, objektivat dhe i kemi inkorporuar në gjendjen ekzistuese edhe në profilin e Komunës, tanë planifikojmë të mbajmë një prezantim të punës së deri tanishme që është bërë, unë ju ftoj edhe sot, ju lajmëroj me kohë

se kur do të bëhet prezantimi kërkoj që nga secili asamblist, nga secili përfaqësues i shoqërisë civile që të kontribuojë rrëth hartimit të këtij plani sepse ky plan është një ndër planet kryesore të planifikimit të një Komune, po ashtu do të vazhdojmë edhe me takime apo dëgjime publike me vendbanimet kryesore të Komunës që kërkesat e qytetarëve të secilit vendbanim të përfshihen në këtë plan.

Dervish Çadraku- Faleminderit prej drejtorit që na dha këtë informatë, unë po e shoh këtu që ka disa mbledhje që janë mbajtur d.m.th me datën 13,19, 28 sipas fjalës edhe ato të shkruara ky staf do të ketë edhe takime me qytetarë, unë mendoj që është mirë të ketë edhe një takim me anëtarët e Kuvendit dhe vetëm me anëtarët e Kuvendit dhe të prezantohet plani, cili është plani deri ku kemi arritur dhe a kemi ndonjë vërejtje apo s'kemi kjo është çështje për të cilat bisedohet pastaj atje, prandaj është mirë që të na jipet mundësia neve kuvendarëve që të kemi qasje ose të na prezantohet neve edhe vizualisht jo vetëm me këtë letër dhe të japid edhe ne mendimet tona para se të shkojë ndoshta tek qytetarët.

Rumir Zhuniqi- Punën rrëth hartimit të planit zhvillimor ne e vazhdojmë në bazë të një programi që e ka miratuar Kuvendi vitin e kaluar mesa më kujtohet në muajin mars të vitit 2017 në bazë të atij plani janë të përcaktuara edhe detyrat që ne i zbatojmë, tani jemi në këtë pikë që e kemi përfunduar profilin e Komunës është gjendja ekzistuese, ndërsa tash vazhdojmë me vizionin dhe skenarët kah do ta orientojmë Komunën, besoj që parashihet që edhe me Kuvend mesa e di unë që duhet të thirret një seancë e veçantë dhe të diskutohet plani zhvillimor komunal në Kuvend.

Kryesuesi- Kalojmë në pikën e 6 të rendit të ditës Shqyrtimi i informatës rrëth dëmeve në bujqësi, ftoj drejtorin Berat Duraku .

Berat Duraku-Përvendetje edhe njëherë, lidhur me informatën për dëmet në bujqësi ju veçse të gjithë jeni në dijeni lidhur me kohën e keqe që na ka kapluar, pikërisht më datën 14 qershor ka filluar breshëri i përcjellë me shi të rrëmbyeshëm që ka përfshirë një sipërfaqe të madhe të Komunës tonë, diku rrëth 2280ha janë përfshirë nga breshëri, përveç breshërit ka pasur edhe vërvshime ku proçkat e Komunës tonë kanë dalë prej shtratit edhe kanë bërë dëme, Kryetari i Komunës ka formuar komisionin, ky komision ka filluar punën prej ditës së parë të punës pas ditës së bajramit, komisioni ka qenë i ndarë në grupe duke përfshirë kështu tërë Komunën ku kanë qenë të prekur nga dëmet në bujqësi, janë grupuar katër sfera të sektorit të bujqësisë, sfera e perim- kulturës, lavërtarisë, vreshtarës dhe pemëtarisë pjesa më e madhe e sipërfaqes së dëmtuar është me perim- kulturë diku mbi 600ha, pjesa e vreshtarës 420ha, pjesa e lavërtarisë ku bëjnë pjesë drithërat diku 400ha, edhe një pjesë pak më e vogël tek pemëtaria, ju e keni informatën përpara do të ndalesha tek vendbanimet të cilat kanë qenë të prekura më së shumti është qyteti i Rahovecit duke përfshirë edhe Bërnjakën diku me rrëth 560ha, 80 % e vreshtarës ka qenë e prekur në qytetin e Rahovecit, prej vendbanimeve tjera më i dëmtuarit ka qenë fshati Fortesë 275ha, pjesa dërrmuese e kësaj sipërfaqeje ka qenë me spec, duke vazhduar me grurë, misër, kunguj dhe perime të tjera vazhdon si më i dëmtuarit fshati Sopniq me 252ha në fakt këtu drithërat kanë qenë më së shumti të dëmtuar duke mos anashkaluar as specat dhe perimet tjera, vazhdojmë tutje me fshatrat Malësi e Vogël- 110 ha dhe Gegje- 92ha, nga vërvshimet vendbanimet më të dëmtuara kanë qenë në Celinë dhe Krushë të Madhe diku 55ha janë të përfshirë prej ujërave në fshatin Celinë pjesa më e madhe me specë 22ha, Krushë të Madhe 31ha janë total po ashtu edhe këtu pjesa më e madhe është me specë, vazhdojmë tutje fshatrat me sipërfaqen më të vogël që janë Xërxe, Hoqë e Vogë, Potoqan, Dejnë, Ratkoc dhe Nagavc, raportin e kemi përgatitur e kemi publikuar edhe në web- faqe keni pasur mundësi ta shihni, i njëjtë raport i është dorëzuar edhe Qeverisë së Kosovës Kryeministrat z.Ramush Haradinaj dhe Ministrit të Bujqësisë z. Nenad Rikalo, Kryetari ka bërë një presion të jashtëzakonshëm institucioneve qendrore sa që e ka sjellë edhe Kryeministrin në vend të ngjarjes i kemi vizituar të gjitha vendet ku kanë qenë kryesishët më të prekura edhe si rezultat i saj ka rezoltuar që të formohet fondi për kompensim pikërisht këtë vit 6.7 milionë euro janë ndarë për kompensimin e fermerëve të Komunave e që pjesa më e madhe është e fermerëve të Komunës sonë që do të përfitojnë, me rëndësi është që ky fond do të jetë edhe në vitet në vazhdim, kaq kisha unë nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryetari- Faleminderit drejtor, ndoshta për informata shtesë për plotësim të drejtorit pasi që reporti është i publikuar në web- faqë të Komunës edhe i njëjtë i është dërguar Ministrisë së Bujqësisë edhe drejtpërdrejtë Qeverisë Komuna jonë ka pësuar dëme të mëdha në bujqësi më shumë se 4 milionë euro, ndërsa deri më tani kemi dëme edhe në amvisëri, ekonomi familjare, infrastrukturë publike, por deri më tani nga informatat zyrtare që kam janë katër Komuna që kanë bërë raporte për dëmet nga breshëri dhe vërshimet, është Komuna e Rahovecit, Kaçanikut, Lipjanit dhe Ferizajit, gjithsej në bazë të shumave të specifikuara në këto 4 Komuna janë më shumë se 6 milionë euro, në qoftë se reporti siç besojmë ne është profesional, është real, është i kalkuluar mirë atëherë kjo do të thotë që Komuna e Rahovecit, sepse vendimi nënkuption kompensim 100% të dëmeve të shkaktuara në bujqësi, pra fondi këtë vit do të fillojë të shpërndahet menjëherë në listën e gjatë të fermerëve të dëmtuar këtë vit, në qoftë se ne kemi një harmonizim midis rapportit tonë dhe verifikimit nga ana e komisionit qeveritar i bie që Komuna e Rahovecit në këtë fatkeqësi elementare natyrore të jetë përsituese më e madhe sepse edhe reporti tregon vërtetë që dëmet sidomos në bujqësi janë të jashtëzakonshme ju e dini fare mirë të nderuar këhilltarë ne kemi adresuar çështjet që lidhen me prioritetet si vendosja e sistemit raketor, anti- breshër, pastaj kemi kërkuar edhe që pikërisht ky fond ka qenë formimi i fondit për përkrahje të fermerëve pastaj sigurime bujqësore, përspejtimi i subvacioneve, ju e dini që subvencionet veç kanë filluar agjencioni i pagesave po i shpërndan subvencionet edhe pse është pritur që më vonë të shpërndahen ka një dinamikë që natyrisht në këtë fatkeqësi që e kanë pësuar njerëzit, këto dëme që i kanë pasur fermerët tanë po mendoj që është një përkrahje direkte e Qeverisë së Kosovës edhe për Komunën tonë edhe po mendoj që është lajm i mirë edhe përfaktin se kjo çështje po adresohet edhe për vitin 2019 dhe me siguri do të krijohet edhe tradita e buxhetimit e këtyre situatave ku Kosova mund të ndodhet në kushte të këqija atmosferike, reportin ne e kemi publik edhe reportin e kemi në Qeveri dhe po shpresojmë që komisioni ynë do të jep përgjigje edhe në detaje të çdo elementi që ka vendosur në raport sepse është i kalkuluar, na ka ndihmuar edhe kadastr i vreshtave, edhe Ministria e Bujqësisë sepse i ka disa instrumente shtesë që i ka të regjistruar saktë sa sipërfaqë dhe besoj që do të aprovohet edhe në kuptimin e mbështetjes financiare do të konsiderohet jashtëzakonisht real dhe profesional reporti që ne veç e kemi dërguar atje, këto desha të ju them, për dëmet e shkaktuara nga breshëri nuk jam shumë i sigurt a do të kompensohen dëmet në ekonominë familjare edhe në infrastrukturë publike me këtë fond të krijuar nga Qeveria pra nuk kam shumë siguri, dëshira është e të gjithëve që të kompensohen të gjitha dëmet e jo vetëm këto në bujqësi.

Rasim Fazliu- Fillimisht falënderoj Komunën që ka organizuar komisione të tjera për të dalë menjëherë në vendin e ngjarjes për të bërë vlerësimin në të gjitha këto fusha këtu që i kemi këto informata edhe që keni procesuar e keni dërguar ku duhet, falënderoj edhe Qeverinë qendrore që ka marrë hapin të i kompensojë dëmet në bujqësi është një lajm shumë i mirë për qytetarët e Komunës së Rahovecit, kështu që informatat i kemi i kemi lexuar edhe në shtëpi, konsideroj që nuk kemi ne këtu për të bërë debat, edhe Kryetari e plotësoi paska, ajo çka nuk më pëlqeu është çështja që dëmet që janë bërë në amvisëri dhe ekonomi familjare dhe infrastrukturë publike shpresoj të kompensohen përndryshtë është një mangësi, e për bujqësi është lajm i mirë që do të kompensohen prandaj kisha thënë që këto tri pika të shkojnë pak dhe mos të bëhen debat se s'janë për debat këto, kjo është informatë e ne e kemi informatën e kemi lexuar të gjithë si dhe na dhatë shtesë informata e kështu që ju falënderoj.

Dervish Çadraku- Reshjet që kanë qenë anë e mbanë Kosovës e sidomos në Rahovec kanë qenë reshje aq të mëdha e aq të dëmshme sa që edhe shtetet më të fuqishme do të ishte problem ti përballonin dhe urbanikisht më të rregulluara se ne ka qenë e vështirë për ti përballuar kështu që dëmet janë evidente këtë e dimë të gjithë, uroj që këto dëme të kompensohen sado pak nga Qeveria qendrore dhe pjesërisht ndoshta diçka edhe prej Komunës dhe këta bujqë të shkretë të cilët kanë dhënë kaq shumë dhe të dalin me rezultat zero është me të vërtetë për keqardhje por unë mendoj që është më së miri të merremi me shkaqet se sa me pasojat, kështu që unë e vlerësoj punën tuaj që e keni bërë evidentimin e pasojave nga shirërat dhe nga breshëri në tërë Komunën tonë por mua më intereson tjetra se çka keni punuar në këtë drejtim që

mos të ndodhin d.m.th jo për pasojat po për shkaqet që kanë ndodhur ato sepse ka shumë rëndësi të dihet a është biseduar diçka për mbrojtjen nga breshëri, e gjithë Evropa mbrohet nga breshëri kurse ne nuk kemi mekanizma ose është mekanizmi por është jo funksional, e dyta ne e dimë që ka kanale të gjera por ka edhe kanale të ngushta, e dimë që ka ura të gjera por ka edhe ura të ngushta, e dimë që nuk ka kanale hiç, e dimë që ka ndërtim pa leje, dhe shkaku i këtyre uji ka devijuar d.m.th ka dalë nga shtrati ka marrë edhe amvisërëtë edhe fushat edhe të gjithë atë që quhet pasuri e qytetarit, a është evidentuar diçka në këtë drejtim që këto gjëra që e kanë kushtëzuar këtë si është p.sh tek ura, tek kanalizimet, tek rrjedha, tek mbajtja nën kontroll e shtratit të lumenjve, a është biseduar që të futet në buxhet në mënyrë të mos merremi gjithmonë me pasojat por të merremi me shkakun dhe njëherë e mirë të i rregullojmë këto probleme sepse kjo me të vërtetë po na kushton dhe në njëfarë mënyre pafundësisht po vazhdon kështu.

Kryetari- Ne kemi ndërmarrë disa masa edhe si Komunë kemi bërë disa veprime që na sigurojnë që eventualisht në qoftë se do të përballemi do të përballemi më lehtë në të ardhmen p.sh kemi marrë disa veprime në Krushë të Madhe kemi hapur disa kanale edhe si Komunë për të i zbutur kushtimisht pikat kritike, ne i kemi prioritet shtretërit e përrrenjve, lumenjve dhe po besojmë që përkrahja e Qeverisë përkatësisht Ministrisë së Planifikimit nuk po mungon dhe ne paraprakisht e dimë tash se çfarë përkrahje do të marrim edhe nga Qeveria qendrore për të i eliminuar shkaqet që i kanë prodhuar këto pasoja, sistemi anti-breshë , në dy takime zyrtare që i kam pasur me Ministrin e Bujqësisë dhe në disa takime me Kryeministrin është një problem pak më kompleks sipas interpretimit të tyre që lidhet me të ashtuquajturën autostradë ajrore edhe unë ju kam bërë një pyetje a ka sistem anti-breshër në Serbi ose në Gjermani, ka atje autostrada ajrore është shumë më e ngarkuar por unë po besoj që ashtu siç ka ardhur ky lajm pozitiv për fermerët po shpresojmë që të kemi lajme pozitive për të hyrë në projekte pak më serioze zhvillimore e jo vetëm të përballemi me fatkeqësi e pastaj edhe të kompensohen ata që dëmtohen nga fatkeqësitetë por besoj që sistemi raketor anti-breshër është adresuar qartë edhe me ndihmën e juaj sepse unë e kam marrë aprovimin e juaj në seancën urgjente dhe kanë për tu gjetur modalitete ose ekspertizat e nevojshme me aviacionin civil, me Kforin, janë plotë akterë që marrin pjesë në këtë proces dhe besoj që do të adresohet, unë nuk po them nesër ose pasnesër por kjo temë do të adresohet, Komuna jonë po del njëfarë flamurtari për të i ndihmuar Kosovës për shkak se goditjet i kemi pasur më të forta dëmet i kemi pasur më të mëdha dhe serioziteti i përballjeve tona ka qenë më i madh edhe jo që nuk ka ndodhur ndoshta në të kaluarën por ra kjo punë dhe Qeveria e Kosovës në një mënyrë ose tjerët duhet të gjejë zgjidhje për dëmet të cilat në rastin konkret janë të pallogaritshme për fermerët tanë , ne si Komunë kemi prioritet trajtimin e shtretërve të përrrenjve dhe lumenjve , zgjerimi kanaleve, etj edhe njëherë ju falënderoj në qoftë se jemi dakord ne e njëjtë situatë është edhe me dëmet në infrastrukturë publike, ekonomi familjare dhe unë jam dakord me atë që e tha z.Rasim Fazliu.

Kryesuesi- Meqë edhe pika e 7 dhe 8 janë informatë kalojmë në pikën e 9 të rendit të ditës ,Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P - 71510057- 06249 – 0 për këtë pikë ftoj drejtorin z.Afrim Oruqi.

Dervish Çadraku- Flas në emër të grupit tim a ka mundësi këto pika të gjitha të janë bashkë në një pako sepse nuk jemi asnje të interesuar të i ndryshojmë.

Munib Durguti- Në aspektin procedural desha vetëm një vërejtje sepse ne e aprovuam në fillim të seancës këtë rend dite, nëse bëjmë propozime për ndryshimin e pikave të rendit të ditës biem në një situatë konfliktuze me procedurat e kuvendit.

Kryesuesi- z.Çadraku e pat një propozim që të shkohet si pako për votim, kush është për propozimin e z.Qadraku , konstatoj se me shumicë votash aprovohet propozimi i z. Qadraku që të shkohet në votim.

Afrim Oruqi- Faleminderit Kryesues, tri pikat kanë të bëjnë, qëllimi është i njëjtë shpallja me interes të përgjithshëm për mbrojtje, ruajtje, mirëmbajtje të vendit të dëshmorëve, heronjve të kombit, të tri zonat janë në qytet, ndërsa për pikën e katërt kemi të bëjmë për shpalljen me interes në zonë të veçantë në zonën kadastrale në Ratkoc që ka të bëjë me planin zhvillimor të Komunës, të parcelës pronë shtetërore e

Komunës e quajtur Lijaline, ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të i përkrahin dhe votojnë propozim vendimet e Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi- Faleminderit drejtor, tani i qesim në votim pikën 9, 10, 11, 12 të rendit të ditës, konstatoj se në mënyrë unanime aprovojen këto 4 pika të rendit të ditës, kalojmë në pikën e 13 të rendit të ditës, Shqyrtimi i Kërkesës së Kryetarit të këshillit të prindërve të Komunës së Rahovecit është fjala për Kryetarin z. Ymret Reshitit i cili ju është drejtuar të gjithë kuvendarëve me një kërkesë, kjo ka qenë edhe kërkesë e anëtarit të KPF-së z.Fehmi Cena që të kalohet në Kuvend, për këtë pikë ftoj shefin e zyrës ligjore z.Isak Hoti.

Isak Hoti- I nderuar Kryesues, Kryetar, Nënkyetar, Delegatë dhe të gjithë ju të pranishëm, unë po e jap veç opinionin e zyrës ligjore rrëth kompensimit të anëtarit në këshillin e KKSB-së, neni 80 i ligjit përmenaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e specifikon qartë dhe unë po e citoj: Nëse një nепунës, shërbyses civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore sipas një akti të qeverisë kërkohet që të shërbujejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik ky punonjës, shërbyses civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë dhe nuk do të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë përkëtë shërbim, shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur, pastaj e kemi edhe një njoftim të datës 06.01.2015 të ish ministrit të atëhershëm të financave z. Abdullah Hoti ku e citon nenin 80, më duhet ta lexoj edhe këtë edhe pastaj të ju shpërndaj edhe një kopje edhe juve nuk ka problem, thotë data 06.01.2015 drejtuar të gjitha organizatave buxhetore . Abdullah Hoti ministër i atëhershëm i financave njoftim, kompensimi shtesë përpunonjës, shërbyses civil ose zyrtarëve të organizatave buxhetore të angazhuar në trupa të tjerë me akte të qeverisë është e ndaluar konform ligjit të financave publike, e ka cituar njëjtë ashtu siç edhe e citova nenin 80 të ligjit përmenaxhimin e financave publike, i njëjti ligjin në nenin 81.1 ka paraparë epërsinë e këtij ligji në çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurisë publike, në rast të kolizionit eventual me ndonjë dispozitë tjetër ligjore siç e kemi udhëzimin administrativ për KKSB-në , në rast të mospërputhjes me ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurisë publike, dispozitat e ligjit përmenaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë do të kenë përparësi, në fund thotë ju njoftojmë se ministria e financave do të ndërmarrë të gjitha hapat ligjor të paraparë me këtë ligj për shkelje të dispozitave të tij nga ndonjë organizatë buxhetore, unë nuk kam çka them më tepër rrëth kësaj d.m.th është e ndaluar ose edhe unë çdo seancë marr pjesë këtu a do të thotë që do të paguhem , jo është pjesë e punës.

Fehmi Cena- Kjo pikë e rendit të ditës është futur këtu me aprovin e shumicës së votave të KPF-së, e vërteta është që të gjithë ne delegatët e kemi pasur këtë kërkesë të Kryetarit të Këshillit të Arsimit Komunal, unë jurist nuk jam mirëpo ma ka marrë mendja që i njëjti është anëtar i Këshillit të Arsimit Komunal, por është edhe Kryetar i Këshillit të Arsimit Komunal në nivel të Kosovës, arsyeshmërinë më të madhe e kam marrë ai i përshkruan disa arsyet këtu unë besoj që edhe ju të gjithë delegatët e keni marrë kërkesën këtu së paku përmes e-mailit duke qenë se është edhe në KKSB ka kërkuar që të i paguhet mëditja në mbledhje që merr pjesë por ta shfrytëzojë atë për nevojat e Këshillit Komunal të Arsimit si Kryetar që është ai ka obligime shtesë organizon disa aktivitete Këshilli i Arsimit nuk ka fonde të veçanta përtë i mbuluar shpenzimet dhe së paku ne me e përkrah atë në mënyrë simbolike së paku materialisht, ne në mbledhje të mëhershme e kemi pasur gjithashtu edhe një informatë nga Drejtori i DKA-së ku kemi pasur disa rekomandime të thëna edhe nga vetë Drejtori që edhe ne vetë i kemi përkrahur që edhe Këshilli i Prindërve të Arsimit e ka rëndësinë e tij me angazhimet e tyre për ngritjen e cilësisë në arsim, ne nëse duam ta ndihmojmë këtë Këshill duke qenë se nuk ka fonde të tjera nuk është e tepërt nëse ai paguhet në emër të një mëditjes në mbledhje të KKSB-së me vlerë 30, 40 ose 50€ që është përmua një shumë simbolike, që së paku ata njerëz disa nevoja ti kryejnë për shërbimet e tyre, nëse ligji decidivisht nuk e lejon këtë unë nuk jam përt ta shkelur ligjin unë e thashë jurist nuk jam unë jam doktor, në mbledhjen e KPF-së ligji decidivisht nuk na është lexuar por pak a shumë një sugjerim e kemi pas prej

zyrtarit ligjor sot ai i lexi ato, nëse ka mundësi ne ta kalojmë këtë unë nuk e shoh si diçka të keq përndryshe nëse ka ndonjë pengesë ligjore që do të refuzohet edhe nga instanca të tjera atëherë ajo është diçka tjetër.

Kryetari- Mbështetjen morale udhëheqësi i personelit e ka pa dyshim sepse është pjesë e Komunës edhe në qoftë se bëhet fjalë për zgjatje të orarit të punës sipas ligjit natyrisht që ne i kompensojmë sipas ligjt ashtu siç do të ju kompensojmë këtyre që punojnë me orar të zgjatur e që është traditë në Komunën tonë, nesër e kemi takimin e radhës të KKSBB-së edhe unë e ftoj Kuvendin e Komunës që natyrisht mbështetjen morale, ligjore do ta ketë por është në kundërshtim të plotë me ligjin, unë kam sugjerim edhe nga përfaqësuesit e departamentit të ligjeve në MAPL të mos merrni vendime sepse do të ju kthehen prapa, pra unë edhe ashtu e ndihmoj sepse është udhëheqës i zyrës së personelit sepse unë mundem edhe mos ta ndihmoj se ne e kemi edhe një pajisje për hyrje dalje, për besë duhet ta keni parasysh shko me një shkollë e shko në Prishtinë e shko atje edhe këto janë me pasoja për Komunën sepse udhëheqësi i personelit është pozicion kyç ju e dini më mirë se unë, unë i kam thënë edhe z.Reshitit që duhet të kesh kujdes gjatë orarit të punës vetëm punë zyrtare në cilësinë e udhëheqësit të personelit, çdo punë tjetër që mund të jetë shumë më me qëllim të mirë ose ku ta di unë bie në kundërshtim sepse ne e kemi programin, e dini ju çka është ai program, pra i vijueshmërisë, ishallë ka ndonjë ligj që i paguan të tëra ato përgjegjësi që ai ka marrë, por mos ta harrojmë që udhëheqësi i personelit ndoshta duhet të i shikojë dosjet dhe të kontaktojë me ju mos të dalim keq para auditorit, unë e njoh është një jurist mjafit i zoti edhe e di që po të ishte ai këtu nuk do të i bënte thirrje Kuvendit për ta votuar për shkak se është një çështje e jashtëligjshme, faleminderit shumë ai nesër do të jetë anëtar i KKSBB-së në cilësinë të cilën e ka, pagesa nuk ka mundësi të i bëhet, në qoftë se mundem moralisht do mundohem të i ndihmoj por pagesa nuk jam i gatshëm ti ndihmoj as atij e as vetes sepse jemi në kundërshtim me ligjin.

Rasim Fazliu- Edhe ne e kemi kërkesën e tij këtu përpëra por puna është që ligji është ligj dhe ligji është mbi të gjithë në qoftë se ligji e parashevë që shërbyesit civil mos të paguhen edhe ne si anëtarë të Kuvendit nuk jemi për ta shkelur ligjin por jemi për ta zbatuar ligjin, por unë diçka ju kisha drejtuar Kryetarit të Komunës që ligji të zbatohet në përpikëri për të gjithë anëtarët e KKSBB-së në qoftë se dikush kushdo qoftë ai se unë nuk e di tash një shërbyes civil paguhet atëherë edhe ky le të paguhet por në qoftë se asnjë shërbyes civil nuk paguhet atëherë edhe ky nuk ka si të paguhet apo jo sepse ne jemi për me respektu ligjin d.m.th edhe ne për çështje buxhetore nuk është kompetencë e jona të merremi me këto gjëra, është ekzekutivi edhe Kryetari që merret me këto gjëra kë e paguan dhe kë se paguan gjithmonë duke e zbatuar ligjin, kështu që ne nuk kemi nevojë as ta qesim këtë në votim as për ta paguar as për mos ta paguar, por kërkoi që Kryetari si autoritet që është këtu udhëheqës i Komunës së Rahovecit atij të ja lëshojë një vendim që për shkak të nenit, ligjit nuk ke të drejtë të paguhesh ose ke të drejtë të paguhesh si shembull po e marr, pra përgjigje në kërkesë edhe unë me kaq e përfundoj.

Dervish Çadruku- Unë e kam një listë të emrave të anëtarëve të KKSBB-së janë gjithsej 24 sa kisha mundësi ta konstatoj këtë listë mua po më dalin edhe dy të tjerë që janë shërbyes civil dhe nuk e di nëse këta të dy kanë bërë kërkesë për të ju bërë pagesa edhe këtyre dyve apo jo në qoftë se është që sipas ligjit nuk lejohet pagesë e dyfishtë e një shërbyesi civil në punë tjera atëherë unë mendoj që është mirë që këtu tek numër 8 kompensimi për anëtarët e KKSBB-së për pjesëmarje në takim bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të KPF-së është mirë të potencohet përvèç shërbyesve civil për arsy se po krijohet një lloj hutie, ne nuk duam as më shumë e as më pak veç se secili të jetë i përgjegjshëm para ligjit kushdo qoftë ai prandaj në qoftë se është bërë shkelje duhet të i kompensohet e në qoftë se është me ligj që nuk duhet paguar, sigurisht që ne do të shkojmë sipas ligjit.

Sali Sallteku- Përshëndetje për të gjithë, e tha mirë edhe shefi i grupit tonë nuk është dashur as të bisedohet për këto punë hiç, këto janë punë të Qeverisë edhe ne nuk duhet të merremi fare me këtë punë, kështu që mos na maltroton më shumë ai le të ankohet e ka Qeverinë e ka Kryetarin le të bëjë çfarë të dojë pse ne të merremi me këtë punë.

Kryetari- Smajl Latifi udhëheqës publik nuk paguhet, Osman Ismajli nuk paguhet, Xhavit Kelmendi nuk paguhet, Nysret Abazibra paguhet, Ilvi Shehu paguhet, Sabahudin Durguti paguhet, Velia Stojkoviç paguhet, Aleksander Veqeviç paguhet, Bujar Morina paguhet, Ramë Berisha paguhet, Bajram Morina paguhet, tash Ekrem Bytyçi shërbyes civil nuk paguhet, Avni Morina udhëheqës publik nuk paguhet, Ymret Reshitit shërbyes civil nuk paguhet, Enis Berisha shërbyes civil nuk paguhet, Beqir Hamza shërbyes civil nuk paguhet, Sihana Duraku, Lulzim Krasniqi, Shaip Shala, Fadil Sylka dhe Haxhi Hoxha paguhën, Goneta Mustafa nuk paguhet, Jovan Bojiç shërbyes civil nuk paguhet, pra është gjithçka e kthjellët si loti.

Mirjeta Krasniqi- Edhe unë pajtohem për respektimin e ligjit mirëpo çka kisha mundur të sugjeroj është që nëse si Kryetar i Këshillit të Prindërve në nivel komunal kur ka takime brenda komunës në kuadër të DKA-së ta shfrytëzojë veturën ose diçka kështu, ta marrë veturën dhe të shkojë për qëllime të arsimit, problematikave që ne hasim nëpër shkolla, nuk është e rendësishme gjithmonë me përfitë por të zhvillohen kushte ta zhvillojë punën, a mundet në kuadër të DKA-së ta shfrytëzojë veturën ose diçka në infrastrukturë ose material.

Kryesuesi - Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:05

Procesmbajtësi

Skender Hamza

